

Laura Pruthi

Libër për mësuesin/en

Shkathtësi për jetë **5**

Libër për mësuesin/en

Shkathtësi për jetë **5**

ISBN: 978-9951-843-06-5



9 789951 843065



BOTIME

pegi

Laura Pruthi

LIBËR PËR MËSUESIN/EN **SHKATHTËSI PËR JETË 5**

Për klasën e pestë të arsimit fillor

BOTIME



Prishtinë, 2023



BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTi-t: ??????????
Korrektore letrare: Ornela LECI
Paraqitja grafike: Enkeleda REXHA
Kopertina: Elvis BEJTJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-843-06-5

© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, gusht 2023
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohej çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: cel: +355 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355 069 20 267 73; 069 40 106 88;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

PËRMBAJTJE

HYRJE	5
PLANI VJETOR	16
PLANI PËR GJYSMËVJETORIN E PARË.....	17
PLANI PËR GJYSMËVJETORIN E DYTË.....	25
ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE.....	30
TEST	103
REFERENCA	112

Hyrje

Të nderuar mësimdhënës/e,

Libri i mësuesit do t'ju shërbejë si udhëzues për t'ju orientuar dhe për t'ju ndihmuar në planifikimin dhe realizimin e situatave të nxënësve në klasë, duke iu mundësuar nxënësve përvetësimin dhe zbatimin gradual të kompetencave të shkallës së dytë të parapara në KK.

Organizimi i mësimit është përqendruar në atë çka duhet të dinë dhe në atë se çka duhet të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit e këtij niveli. E gjithë kjo duhet të pasqyrohet përmes njohurive, shkathtësive, shprehjeve, qëndrimeve dhe sjelljeve që ata duhet të reflektojnë. Lënda “Shkathësi për jetë”, në klasën e pestë është e orientuar drejt përvetësimit të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave për të ngritur vetëdijesim dhe vetëbesim për ushtrimin e punës praktike, përdorimin e TIK-ut, bashkëpunimin lidhur me ekonominë familjare, me mjedisin jetësor, këshillimin dhe orientimin në karrierë, si dhe puna dhe edukimi për ndërmarrësi.

Prej planifikimit të mirëfilltë në *Librin e mësuesit*, mësimi bëhet më atraktiv dhe më i kënaqshëm, përmes punës praktike, projekteve, aktiviteteve jashtëklase, hulumtimeve, lojërave, aktiviteteve të ndryshme praktike, në të cilat nxënësit nxiten që të marrin pjesë. Synimi kryesor në klasën e pestë është që nxënësit të identifikojnë interesimet e tyre për ndonjë veprimtari apo shkathtësi, siç janë: përdor pajisje të thjeshta teknike, përdor programe kompjuterike për krijimin e modeleve, si origami, *crafts* për punëdore, hulumton diversitetin ekologjik në mjedisin jetësor etj. Me përdorimin e TIK-ut, nxënësit do të aftësohen të gjejnë informacione nga një shumëllojshmëri burimesh, të përzgjedhin dhe të sintetizojnë informacionin për të përmbushur nevojat e tyre. Gjithashtu, ata do të jenë në gjendje të zhvillojnë idetë e tyre, duke përdorur mjete të TIK-ut për të përmirësuar cilësinë, për ta ndryshuar dhe përsosur punën e tyre.

Kjo lëndë përfshin përpjekjet sistematike për të ndikuar në procesin e zhvillimit të nxënësve, të cilët, përmes procesit të të mësuarit, përdorin materiale të ndryshme, mjetet e punës që kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive për jetë dhe punë. Lënda ndikon te fëmijët në zhvillimin e mendimit kritik, zhvillimin e aftësive për të zgjidhur probleme, nxitjen e kreativitetit, aftësinë prezantuese, rritjen e vetëbesimit dhe punën ekipore. Pra, planifikimi i procesit mësimor është bërë në mënyrë të integruar, duke mundësuar që marrëdhënia e fëmijëve me mjedisin natyror dhe me mjedisin e krijuar nga njeriu dhe lidhshmërinë me situata jetësore, të kuptojnë në mënyrë sa më të plotë. *Libri i mësuesit* shtjellon strategjitë dhe teknikat e të pyeturit si elemente delikate gjatë orës mësimore, gjithashtu disa nga metodat, teknikat, aktivitetet e mësimdhënies që iu vijnë në ndihmë gjatë planifikimit dhe realizimit të situatave të nxënësve, konkretisht që janë përdorur gjatë planifikimit të njësive mësimore në këtë libër.

Temat e shtjelluara duke u bazuar në librin e nxënësit janë:

1. Shkathësi për jetë – punëdore
2. Puna me projekte përmes TIK-ut - krijimi i crafts
3. Mjedisi dhe shëndeti
4. Ekonomia familjare
5. Karriera

6. Media

Libri i mësuesit, ashtu si edhe vetë teksti mësimor, janë hartuar duke pasur si synim mësimdhënien dhe të nxëniet bazuar në kompetenca. Njësitë mësimore janë kompozuar në mënyrë të tillë që përkufizimet dhe shprehjet e reja të jenë sa më të qarta. Për këtë shërbejnë ilustrimet, shembujt nga jeta e përditshme. Modelet për hartimin e këtij teksti mësimor janë përzgjedhur duke u bazuar në temat dhe rezultatet e lëndës të dhëna në programet lëndore për klasën e pestë, miratuar nga MASHT. Në planifikimin e njësive mësimore në librin e mësuesit/es janë përdorur metodologjitë në përputhje me kërkesat për implementimin e KK. I gjithë planifikimi bazohet në: mësimdhënie dhe nxënie, me nxënësin/en në qendër dhe gjithëpërfshirje; mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në qasjen e integruar; mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në arritjen e kompetencave dhe mësimdhënie e nxënie të diferencuar. Metodologjia e vlerësimit është bazuar në vlerësimin formues, duke menduar gjithmonë si të realizohet një vlerësim i vazhdueshëm i nxënësit/es.

Mësuesi/ja është i lirë t'i ndryshojë çdo gjë sipas nevojave të nxënësve. Çdo model, që ka të bëjë me planifikimin, situatat e të nxëniet, metodologjinë apo vlerësimin, krijohet mbi një bazë të caktuar të nivelit të klasës ku ai/ajo jep mësim.

Libri për mësuesin përmban:

- Hyrjen
- Planin dhe programin e lëndës “Shkathtësi për jetë”, klasa e pestë
- Planin vjetor
- Planet dymujore
- Planifikimet ditore për njësitë mësimore
- Testet përmbledhëse

Programi i lëndës “Shkathësi për jetë”, klasa e pestë

Hyrje

Lënda *Shkathësi për jetë* në klasën e pestë është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive drejt përvetësimit të njohurive të reja, shkathësive, qëndrimeve dhe vlerave për të ngritur vetëdijesim dhe vetëbesim për ushtrimin e punës praktike, përdorimin e TIK-ut, bashkëpunimin lidhur me ekonominë familjare, me mjedisin jetësor dhe orientim për jetë dhe punë. Lënda *Shkathësi për jetë* ndihmon që nxënësit të përgatiten për punë dhe jetë në shekullin XXI, t’iu përshtaten sa më mirë ndryshimeve të kohës, duke e kaluar theksin në zhvillim të kompetencave, shkathësive dhe qëndrimeve përmes mësimnxënies aktive. Në kuadër të lëndës *Shkathësi për jetë*, do të zhvillohen module të cilat synojnë të përmbushin konceptet kryesore të fushës Jeta dhe Puna për shkallën 2, si: punëdore, teknologji duke përfshirë TIK-un, zhvillimi personal, edukimi për zhvillim të qëndrueshëm, ekonomi familjare, këshillimi dhe orientimi në karrierë, si dhe puna dhe edukimi për ndërmarrësi. Të gjitha këto koncepte zhvillohen në ndërlidhje të rezultateve të fushës dhe të lëndës, për të arritur qëllimin kryesor të fushës Jeta dhe Puna. Kjo lëndë përfshin përpjekjet sistematike për të ndikuar në procesin e zhvillimit të nxënësve, të cilët, përmes procesit të të mësuarit, përdorin materiale të ndryshme, mjetet e punës që kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e shkathësive dhe aftësive për jetë dhe punë.

Lënda ndikon te fëmijët në zhvillimin e mendimit kritik, zhvillimin e aftësive për të zgjidhur probleme, nxitjen e kreativitetit, aftësinë prezentuese, rritjen e vetëbesimit dhe punën ekipore.

Nxënësit e kësaj moshe vijnë në shkollë me njohuri, gjykime, opinione dhe pyetje të marra nga burime të pafundme digjitale të informacionit, të cilat mësimdhënësi/ja duhet t’i konsiderojë si pjesë të kurrikulës në tërësinë e saj.

Qëllimi

Qëllimi i lëndës *Shkathësi për jetë* për klasën e pestë është që nxënësi të njihet me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe punë, të njihet me materialet ndërtimore dhe përdorimin e tyre, të punojë projekte përmes TIK-ut - krijimin e zanatit, të jetë pjesë e planifikimit të ekonomisë familjare, si dhe të përvetësojë njohuri të reja për mjedisin dhe shëndetin, zhvillimin e karrierës, mediat.

Nëpërmjet kësaj lënde rritet niveli i njohurive dhe shkathësive për jetën e përditshme, duke përfshirë konceptet bazë të fushës Jeta dhe Puna.

Përmes lëndës *Shkathësi për jetë* për klasën e pestë, mësimi në shkollë bëhet më atraktiv dhe më i kënaqshëm përmes aktiviteteve të ndryshme praktike, në të cilat nxënësit nxiten që të marrin pjesë. Synimi kryesor në klasën e pestë është që nxënësit të identifikojnë interesimet e tyre për ndonjë veprimtari apo shkathësi, siç janë: shkathësitë duke përdor pajisje të thjeshta teknike, përdor programe kompjuterike për krijimin e modeleve, si origami, *crafts* për punëdore, hulumton diversitetin ekologjik në mjedisin jetësor etj.

Me përdorimin e TIK-ut, nxënësit do të aftësohen të gjejnë informacione nga një shumëllojshmëri burimesh, të përzgjedhin dhe të sintetizojnë informacionin për të përmbushur nevojat e tyre. Gjithashtu, ata do të jenë në gjendje të zhvillojnë idetë e tyre duke përdorur mjete të TIK-ut për të përmirësuar cilësinë, për ta ndryshuar dhe përsosur punën e tyre.

Shkathtësitë më të rëndësishme jetësore që nxënësi duhet t'i arrijë nëpërmjet lëndës *Shkathtësi për jetë*, janë:

- të menduarit kreativ dhe kritik;
- shkathtësitë duke përdorur pajisje të thjeshta teknike;
- shkathtësitë për përdorimin e programeve kompjuterike;
- shkathtësitë për zgjidhjen e problemeve;
- shkathtësitë e marrjes së vendimeve;
- shkathtësitë e komunikimit;
- ballafaqimi me emocionet dhe stresin;
- aftësitë për të prezantuar;
- puna në grup;
- shkathtësitë sipërmarrëse.

Temat, rezultatet dhe të nxënit

Nxënësit në klasën e pestë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Jeta dhe puna, të shkallës së dytë të kurrikulës (shk. 2) bërthamë për arsimin fillor:

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Zhvillimi i bazuar në aktivitete praktike manuale (Punëdore)	RNF: 1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet 1.1. Përshkruan ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bëhen individualisht dhe në grup 1.2. Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar prodhime të ndryshme punëdore, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim 2. Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë Demonstron gatishmëri dhe vetiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet, duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup	
	TEMA	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	1. Shkathtësi për jetë – punëdore	Nxënësi/ja: • Dallon materialet ndërtimore (argjila, gjipsi, çimentoja, stiropori, mermeri, graniti, kaolina). • Hulumton zbatimin e materialeve ndërtimore (projekt individual). • Krahason vetitë e materialeve (argjila, gjipsi, çimentoja, stiropori, mermeri, graniti, kaolina). • Zhvillon shkathtësitë, duke përdorur pajisje të thjeshta teknike për punimin e projekteve prej materialesh të ndryshme ndërtimore (argjila, gjipsi, stiropori).

Teknologji duke përfshirë TIK-un	RNF: Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet Nxënësi/ja: - Përkruan ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bëhen individualisht dhe në grup. - Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar produkte të ndryshme punëdore, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim. Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë Nxënësi/ja: - Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar produkte të ndryshme punëdore, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim. Përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme Nxënësi/ja: - Përdor vegla dhe pajisje shtëpiake në situata të përditshmërisë. - Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar prodhime të thjeshta bazuar në udhëzimet e mësimdhënësit. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme - Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare. - Përdor i/e/esigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm-mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit - Përpunon materiale ricikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtëse për ruajtjen e mjedisit. - Zhvillon njohuri dhe shkathtësi për shoqërinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë familjare dhe përdorimin e TIK-ut.				
	<table> <tr> <th data-bbox="377 1459 605 1538">TEMA</th><th data-bbox="605 1459 1428 1538">Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</th></tr> <tr> <td data-bbox="377 1538 605 1985"> 2. Puna me projekte përmes TIK-ut - krijimi i crafts </td><td data-bbox="605 1538 1428 1985"> Nxënësi/ja: - Tregon ecurinë e krijimit të një projekti në TIK me <i>crafts</i>. - Përkruan fazat e krijimit dhe prezantimit të një projekti përmes TIK-ut. - Përdor programe kompjuterike për krijimin e modeleve, siç janë origami, <i>crafts</i> për punëdore. - Modelon forma të ndryshme me <i>crafts</i> përmes skicave dhe modeleve që gjenden në internet. - Krijon projekte shkollore me programe kompjuterike me fokus në punëdore (<i>crafts</i>, origami). </td></tr> </table>	TEMA	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)	2. Puna me projekte përmes TIK-ut - krijimi i crafts	Nxënësi/ja: - Tregon ecurinë e krijimit të një projekti në TIK me <i>crafts</i>. - Përkruan fazat e krijimit dhe prezantimit të një projekti përmes TIK-ut. - Përdor programe kompjuterike për krijimin e modeleve, siç janë origami, <i>crafts</i> për punëdore. - Modelon forma të ndryshme me <i>crafts</i> përmes skicave dhe modeleve që gjenden në internet. - Krijon projekte shkollore me programe kompjuterike me fokus në punëdore (<i>crafts</i>, origami).
TEMA	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)				
2. Puna me projekte përmes TIK-ut - krijimi i crafts	Nxënësi/ja: - Tregon ecurinë e krijimit të një projekti në TIK me <i>crafts</i>. - Përkruan fazat e krijimit dhe prezantimit të një projekti përmes TIK-ut. - Përdor programe kompjuterike për krijimin e modeleve, siç janë origami, <i>crafts</i> për punëdore. - Modelon forma të ndryshme me <i>crafts</i> përmes skicave dhe modeleve që gjenden në internet. - Krijon projekte shkollore me programe kompjuterike me fokus në punëdore (<i>crafts</i>, origami).				

Zhvillimi personal (shkathësi për jetë) Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm	RNF: 8. Komunikimi në/për jetë dhe punë 8.1. Është i vetëdijshëm për ekzistencën e diversitetit individual në klasë, në shkollë dhe në jetë, për të përmirësuar të kuptuarit, dëshirat dhe aspiratat e të tjerëve, duke menaxhuar situatat dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë konstruktive dhe paqësore. 9. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit 9.2. Zhvillon njohuri dhe shkathësi për shoqërinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë familjare dhe përdorimin e TIK-ut. <table border="1" data-bbox="362 559 1412 1112"> <tr> <th data-bbox="362 559 589 634">TEMA</th><th data-bbox="589 559 1412 634">Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</th></tr> <tr> <td data-bbox="362 634 589 1112"> 3. Mjedisi dhe shëndeti </td><td data-bbox="589 634 1412 1112"> Nxënësi/ja: - Dallon diversitetin individual në klasë, në shkollë dhe në komunitet, duke përdorur praktika të mira për zgjidhjen e konflikteve. - Hulumton diversitetin ekologjik në mjedisin jetësor në internet. - Liston ditët ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit. - Krijon projekt për aktivitetet sipas kalendarit mjedisor përmes kompjuterit. - Shpjegon ndikimin negativ të mbetjeve të pazbërthyeshme në mjedis dhe në shëndetin e njeriut. </td></tr> </table>	TEMA	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)	3. Mjedisi dhe shëndeti	Nxënësi/ja: - Dallon diversitetin individual në klasë, në shkollë dhe në komunitet, duke përdorur praktika të mira për zgjidhjen e konflikteve. - Hulumton diversitetin ekologjik në mjedisin jetësor në internet. - Liston ditët ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit. - Krijon projekt për aktivitetet sipas kalendarit mjedisor përmes kompjuterit. - Shpjegon ndikimin negativ të mbetjeve të pazbërthyeshme në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.
TEMA	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)				
3. Mjedisi dhe shëndeti	Nxënësi/ja: - Dallon diversitetin individual në klasë, në shkollë dhe në komunitet, duke përdorur praktika të mira për zgjidhjen e konflikteve. - Hulumton diversitetin ekologjik në mjedisin jetësor në internet. - Liston ditët ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit. - Krijon projekt për aktivitetet sipas kalendarit mjedisor përmes kompjuterit. - Shpjegon ndikimin negativ të mbetjeve të pazbërthyeshme në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.				
	RNF: 1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet 1.1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet. 1.2. Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar produkte të ndryshme punëdore, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim. 2. Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë 2.1. Demonstron gatishmëri dhe vetiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet, duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup. 4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme 4.1. Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare. 4.2. Përdor i/esigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike. 5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe planit të biznesit 5.1. Hulumton drejtpërdrejt dhe përfshihet në aktivitete të ekonomisë familjare dhe ushtron përgjegjësi elementare organizative-buxhetore, duke zhvilluar shpirtin e ndërmarrësit.				

Ekonomia familjare	9. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm - mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit 9.1 Përpunon materiale ricikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtëse për ruajtjen e mjedisit. 9.2. Zhvillon njohuri dhe shkathtësi për shoqërinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë familjare dhe përdorimin e TIK-ut.	
	4. Ekonomia familjare	Nxënësi/ja: • Tregon konceptet kryesore të ekonomisë familjare përmes shembujve në jetën e përditshme. • Analizon detyrat, përgjegjësitë e menaxherit të shtëpisë. • Përshkruan si realizohet menaxhimi shtëpiak përmes detyrave praktike. • Hulumton në internet forma të ndryshme të menaxhimit familjar dhe kursimit të pjesëve kryesore të shtëpisë. • Paraqet pjesët kryesore të ekonomisë familjare, duke analizuar dhe llogaritur buxhetin familjar në elemente të ndryshme. • Krijon planin familjar për menaxhimin e shpenzimeve mujore. • Krijon veshje, paketime, pajisje (maketa) të ndryshme nga materialet ricikluese.
Këshillimi dhe orientimi në karrierë	RNF: 4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme 4.1. Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare. 4.2. Përdor sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike. 7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme 7.1. Demonstron përmes veprimeve të veta nevojën për marrjen e përgjegjësi, ndarjen e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, shkollë dhe komunitet.	
	TEMA	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	5. Karriera	Nxënësi/ja: • Paraqet përmes video/foto-ve rrugën e karrierës së prindit apo familjarëve të tij. • Tregon hobin dhe imagjinon përshtatjen e tij me profesionin e preferuar. • Dallon llojet e profesioneve të ndryshme. • Harton një miniplan për shkathtësitë/aftësitë e tij/saj. • Liston ide të ndryshme lidhur me karrierën.

Puna dhe edukimi për ndërmarrësi	RNF 2. Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë 2.1. Demonstron gatishmëri dhe vetiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet, duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup. 4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme 4.1. Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare. 4.2. Përdor i/esigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike. 5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe planit të biznesit 5.1. Hulumton drejtpërdrejt dhe përfshihet në aktivitete të ekonomisë familjare dhe ushtron përgjegjësi elementare organizative-buxhetore, duke zhvilluar shpirtin e ndërmarrësit. 6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë 6.1. Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.	
	TEMA	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	6. Media	Nxënësi/ja: - Organizon aktivitete shkollore sipas ideve të grupit, incizimi, prezantimi e postimi në faqet e shkollës dhe mediat lokale. - Organizon aktivitete dhe gara të ndryshme që paraqesin veprime ndërmarrëse (p.sh., gara për fotografi, vizatime, krijime të ndryshme etj.). - Përdor lojëra të ndryshme kompjuterike me sens ndërmarrës. - Plotëson tabelat ku përcaktohen nevojat dhe shpenzimet në familje, duke përdorur programe kompjuterike. - Fotografon dhe mbledh shenjat sinjalizuese të rrezikut dhe mbrojtjes në punë, si dhe i vendos në tabelat e shkollës.

Udhëzime metodologjike

Për realizimin e përmbajtjeve që përcaktohen në lëndën *Shkathtësi për jetë* për klasën e pestë, mund të përdoren metodat e ndryshme të punës me qëllim të përmbushjes së kërkesave që ka kjo lëndë, por edhe për shkak të specifikave që mbart në vete. Disa prej metodave që e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm, janë metodat e mësimdhënies që në qendër kanë nxënësin.

Mbarëvajtja e orës së mësimi arrihet me sukses gjatë gërshetimit të këtyre komponentëve: njohurive, aftësive, vlerave dhe qëndrimeve.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- diskutimi dhe të nxëniet në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- të mësuarit dhe të nxëniet përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- ushtrimet me luajtje rolesh;
- inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimi i njohurive dhe shkathësive, puna interaktive;
- të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Në të gjitha rastet, zbatimi i metodave apo teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialit dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

Njëra nga metodat më të sakta të përvetësimit të njohurive të TIK-ut, do të ishte realizimi i projekteve të ndryshme në mënyrë që nxënësit të vënë në praktikë njohuritë e marra, si edhe t'i gërshetojnë këto njohuri me njohuritë e lëndëve të tjera.

Në kuadër të lëndës *Shkathësi për jetë*, një ndër qëllimet e rëndësishme të saj duhet të jetë edhe realizimi i çështjeve ndërkurrikulare, që do të ndihmojnë në arritjen e kompetencave kryesore të parapara me KKK. Çështjet ndërkurrikulare që duhet të merren në konsideratë në këtë nivel dhe që mund të trajtohen në vazhdimësi edhe në nivelet e tjera, janë:

- edukimi për qytetari demokratike;
- edukimi për paqe;
- globalizimi dhe ndërvarësia;
- edukimi për medie;
- arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

Lënda *Shkathësi për jetë* duhet realizuar në atë mënyrë që t'u mundësojmë nxënësve përmirësimin dhe zbatimin gradual të kompetencave kryesore të parapara në KKK. Organizimi i mësimit duhet të përqendrohet në atë se çka duhet të dinë dhe çka duhet të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit. Ajo pasqyrohet përmes njohurive, shkathësive, shprehive, por edhe përmes qëndrimeve dhe sjelljeve që ata duhet t'i reflektojnë.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është një element i pranishëm në çdo veprimtari mësimore. Matja dhe vlerësimi janë pjesë përbërëse dhe mjaft të rëndësishme të mësimdhënies në shkollën bashkëkohore.

Nxënësit nxënë mjaft gjatë viteve të shkollimit. Sidoqoftë, jo gjithçka që ata nxënë mund të matet me anë të testeve, edhe për faktin se, për nxënësit e nivelit fillor, përdorimi i teknikave të ndryshme mundëson vlerësim sa më realist, bazuar në karakteristikat e ndryshme të nxënësve.

Lënda *Shkathësi për jetë*, për shkak të natyrës dhe specifikave që ka, kërkon shumëllojshmëri të mënyrave të vlerësimit në baza të rregullta, ku fokusi është mbi të kuptuarit e jetës dhe të punës; konceptet dhe praktikimi i sjelljeve dhe i qëndrimeve pozitive. Me fjalë të tjera, nxënësit duhet të jenë në gjendje në vazhdimësi dhe në mënyrë aktive të zbatojnë në praktikë njohuritë e mësuara në jetën e tyre të përditshme.

Për shkak të specifikave që ka kjo lëndë, do të ishte e vlefshme që, përveç vlerësimit numerik, në masë të madhe të aplikohet vlerësimi përshkrues, pasi puna në grup, projektet, aftësitë psikomotorë, aftësia e të folurit etj., nuk mund të maten me anë të testeve. Për t'i matur dhe për t'i vlerësuar ato, përdoren instrumente të tjera. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë është një procedurë e përshtatshme për lëndën *Shkathësi*

për jetë dhe punë, e cila mund të përdoret në situata të ndryshme mësimore dhe në të gjitha nivelet e shkollimit.

Ekzistojnë disa teknika dhe instrumente që ndihmojnë në vërtetimin e drejtpërdrejtë të veprimtarisë së nxënësit, të cilat përdoren për vlerësim. Ja disa prej tyre:

Buletini i pjesëmarrjes - përshkruhet si një teknikë vërtetimi që mund të përdoret për të vërtetuar, në grupe të vogla ose gjatë diskutimit. Buletini tregon se cili jep ndihmesë, sa shpesh bashkëpunon, sa të vlefshme janë ndihmesat etj.

Lista e kontrollit - është një instrument që përmban një listë me tema, objektiva, njohuri, për të cilat nxënësi do të vëzhgohet. Qëllimi kryesor i listës së kontrollit është të regjistrojë një vlerësim të vazhdueshëm për përparimin e nxënësit, duke dëshmuar se si i përmbush ai detyrat ose objektivat e llojeve të ndryshme. Krahës listës me elementet që do të vërtetohen, jepet edhe një shkallë vlerësuese.

Dosja e nxënësit - është një mjet që mund të përdoret për të treguar modele të punëve të nxënësve, të cilat dëshmojnë përparimin e nxënësit, aftësitë e tij dhe nivelin e punimeve. Dosja mund të përmbajë, për shembull, vizatime, një projekt, një krijim, plane etj.

Dosja ka vlera për këto arsye:

- është një mjet që u jep informacion mësuesit, prindërve dhe nxënësve;
- nxënësit i jep një pasqyrë tërësore të punës së tij;
- duke e përgatitur vetë dosjen, nxënësi luan rol aktiv në procesin e mësimin dhe të vlerësimit.

Materialet mësimore dhe burimet për mësimdhënie dhe për nxënie

Për realizimin me sukses të kompetencave në lëndën *Shkathësi për jetë* është e rëndësishme që të përdoren burime të ndryshme mësimore për t'i motivuar nxënësit dhe për të stimuluar progresin e tyre në mënyrë që të përfitojnë shprehje dhe shkathësi të nevojshme për jetë dhe për punë në përditshmëri. Meqenëse tekstet shkollorë janë burime të vlefshme dhe të rëndësishme të nxënies, qasja e nxënësve në informacion nuk duhet kufizuar vetëm në tekstet shkollorë, por edhe në burime të tjera, të cilat i shërbejnë për të planifikuar dhe për të realizuar procesin mësimor në klasë.

Për realizim më të suksesshëm të lëndës *Shkathësi për jetë*, duhet të përdoret një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet shkollorë, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, librat e punës, broshura, atlase, enciklopedi, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të fushës përkatëse dhe materiale përkatëse pune. Mësimdhënësit, nxënësit dhe bartësit e tjerë të arsimit, po ashtu, mund të angazhohen në hartimin e burimeve të përshtatura mësimore, p.sh., rezultatet e projekteve të realizuara nga nxënësit mund të bëhen burime të vlefshme mësimore për klasa të ndryshme. Mësimdhënësit mund të përgatisin dosje, gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënës. Gjithashtu, është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe për prodhimin e materialeve të ndryshme përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

Çështjet ndërkurrikulare

Në kuadër të lëndës *Shkathësi për jetë*, një ndër qëllimet e rëndësishme të saj duhet të jetë edhe realizimi i çështjeve ndërkurrikulare, që do të ndihmojnë në arritjen e kompetencave kryesore të parapara me KKK. Disa nga çështjet ndërkurrikulare që duhet të merren në konsideratë në këtë nivel, por që mund të trajtohen në vazhdimësi edhe në nivelet e tjera, janë:

- njohja e medias (përdorimi i medias për ta kuptuar botën përreth);

- edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (shërbimet për bashkësinë);
- mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike;
- gjuha dhe shkathësitë e komunikimit;
- zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë;
- puna vullnetare.

Vegëza (linqe) dhe sqarime të ndryshme për zbatim të programit lëndor:

Rezultati:

Organizon aktivitete dhe gara të ndryshme që paraqesin veprime ndërmarrëse (p.sh.: gara për fotografi, vizatime, krijime të ndryshme etj.).

(veprime ndërmarrëse – p.sh., një nxënës fotografon një shitës të akullores duke punuar, duke vëzhguar procesin e punës).

Lojëra të ndryshme për ndërmarrësi:

1. <https://www.moneyprodigy.com/best-business-simulation-games-kids/>
2. <https://online.rider.edu/online-masters-degrees/masters-business-administration/business-money-math-games-k12-students/>

PLANI VJETOR

16

TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE					Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës
Lëndët e fushës kurrikulare	Gjysmëvjetori i parë		Gjysmëvjetori i dytë		Komunikues efektiv: I. 2,3,8; Mendimtar kreativ: II.1,2,3,4,5,6,8; Nxënës i suksesshëm: III. 1, 2, 3, 4, 7, 8,9; Komunikues produktiv: IV. 2,3, 4,8; Individ i shëndoshë: V.2, 7, 8; Qytetar i përgjegjshëm: VI. 3,4,6,7
	Shtator-Tetor 8 orë	Nëntor –Dhjetor 9 orë	Janar- Shkurt-Mars 11 orë	Prill – Maj-Qershor 9 orë	
	Shkathrësi për jetë – punëdore (6orë)	Puna me projekte përmes TIK-ut – krijimi i crafts (5orë)	Mjedisi dhe shëndeti (1orë)	Karriera (3orë)	
Shkathrësi për jetë	Puna me projekte përmes TIK-ut – krijimi i crafts (2orë)	Mjedisi dhe shëndeti (4orë)	Ekonomia familjare (8 orë)	Media (6orë)	

PLANI PËR GJYSMËVJETORIN E PARË

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna

Lënda mësimore: Shkathësi për jetë

Klasa: V

Temat mësimore:

- Shkathësi për jetë – punëdore;
- Puna me projekte përmes TIK-ut – krijimi i crafts;
- Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Komunikues efektiv:

I.1 Lexon saktë me zë një tekst letrar apo joletrar, të palexuar me parë.

I.2 Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar.

I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

I.8 Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta, duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

Mendimtar kreativ:

II.1 Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërës nga format shprehëse.

II.2 Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).

II.3 Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur, apo sjellje të manifestuar nga një a më shumë persona (në klasë/shkollë e jashtë saj).

II.6 Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore, historike) në njërin nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.

II.8 Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

Nxënës i suksesshëm:

III.1 Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.

III.2 Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.

III.9 Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyrë të caktuar, përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Komunikues produktiv:

IV.3 Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupon atë, shqellën apo lagjen, dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshme, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.

IV.4 Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.

IV.8 Paraqet në formë tabelore, grafike, të vizatimit apo në një formë tjetër, aktivitetet e kujdesit që i bën ndonjë qenieje të gjallë, të cilat i mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij/saj.

Individ i shëndoshë:

V.8 Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.3 Propozon vlera shoqërore që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh. besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti, mirësjellja etj.) dhe, me shembull konkret, përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato.

VI.4 Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësues, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.

VI.6 Identifikon dy ose më shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

1.1 Përshkruan ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bëhen individualisht dhe në grup.

1.2 Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetëiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar produkte të ndryshme punëdore, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim.

2.1 Demonstron gatishmëri dhe vetëiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet, duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup.

3.2 Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar prodhime të thjeshta bazuar në udhëzimet e mësimdhënësit.

4.1 Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare.

4.2 Përdor sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathësive praktike.

8.1 Është i vetëdijshëm për ekzistencën e diversitetit individual në klasë, në shkollë dhe në jetë, për të përmirësuar të kuptuarit, dëshirat dhe aspiratat e të tjerëve, duke menaxhuar situatat dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë konstruktive dhe paqësore.

9.2 Zhvillon njohuri dhe shkathësi për shoqërinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë familjare dhe përdorimin e TIK-ut.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Teksti shkollor
Shkathësi për jetë – punëdore (6 orë)	- Dallon materialet ndërtimore (argjila, gjipsi, çimentoja, stiropori, mermeri, graniti, kaolina). - Hulumton zbatimin e materialeve ndërtimore (projekt individual). - Krahason vetitë e materialeve (argjila, gjipsi, çimentoja, stiropori, mermeri, graniti, kaolina). - Zhvillon shkathësitë duke përdorur pajisje të thjeshta teknike për punimin e projekteve prej materialeve	1.1 Materialet Ndërtimore 1.2 Materiale të tjera ndërtimore 1.3 Përdorimi i materialeve ndërtimore 1.4 Vetitë e materialeve ndërtimore 1.5 Veprimtari Praktike 1.6 Krijime me materiale ndërtimore 2.1 Projektet e punëdoreve me TIK 2.2 Krijimi dhe prezantimi	17 orë	Mësimdhënia dhe të nxënit me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirja Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në arritjen e kompetencave Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar Bashkëbiseduese Punë në grup Punë në çift Punë individuale Rruga imagjinare DRTA Stuhi mendimesh Turi i galerisë Vizualizimi	- Buletini i Pjesëmarrjes - Lista e kontrollit - Portofoli i nxënësit - Vlerësim i ndërsjellë - Semafori - Dy yje - një dëshirë - Vetëvlerësim - Vlerësimi i punës praktike	Njeriu dhe natyra • Gjuhë shqipe , • Edukatë figurative • Edukatë muzikore • Edukata fizike, sporte dhe shëndeti • Shoqëria dhe Mjedi • Matematikë • Çështjet ndërkurrikulare • Zhvillimi personal dhe shkathësi për jetë	Teksti shkollor Broshura, Atlase, Enciklopedi Softuerë arsimorë, Materiale dhe mjete të ndryshme pune për punë praktike. https://sourceforge.net/projects/origamieditor3d/https://origami.me/
Puna me projekte përmes TIK-ut - krijimi i crafts (7 orë)							
Mjedi dhe shëndeti (4 orë)							

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temë mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	
	të ndryshme ndërtimore (argjila, gjipsi, stiropori). • Tregon ecurinë e krijimit të një projekti në TIK me crafts. • Përkruan fazat e krijimit dhe prezantimit të një projekti përmes TIK-ut. • Përdor programe kompjuterike për krijimin e modeleve siç janë origami, crafts për punëdore. • Modelon forma të ndryshme me crafts përmes skicave dhe modeleve që gjenden në internet.	i projektit përmes TIK-ut 2.3 Krijimi i modeleve përmes programeve kompjuterike 2.4 Veprimtari Praktike 1.5 Projekt -Projekt, fletore pune f. 17 -Test 3.1 Diversiteti Individual 3.2 Diversiteti Ekologjik		Pyetje binare Ditari dypjesësh Di/dua të di/mësova Copëza të përziera Mësimdhënia e ndërsjellët Harta e konceptit Kubimi Projekt Hulumtim		• Edukim për zhvillim të qëndrueshëm	https://www.google.com/search?q=mbrojtja+e+mjedisit https://www.google.com/search?q=menaxhimi+n%C3%AB+familje

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare
	• Krijon projekte shkollore me programe kompjuterike me fokus në punëdore (crafts, origami). • Dallon diversitetin individual në klasë, në shkollë dhe në komunitet, duke përdorur praktika të mira për zgjidhjen e konflikteve. • Hulumton diversitetin ekologjik në mjedisin jetësor në internet. • Liston ditët ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit.	3.3 Ndotja e mjedisit dhe shëndeti 3.4 Kalendari mjedisor				

Temat mësimore	Rezultatet e të nxëniet për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	
	- Krijon projekt për aktivitetet sipas kalendarit mjedisor përmes kompjuterit. - Shpjegon ndikimin negativ të mbetjeve të pazbërthyeshme në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.						

PLANI PËR GJYSMËVJETORIN E DYTË

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna

Lënda mësimore: Shkathtësi për jetë

Klasa: V

Temat mësimore:

- Mjedisi dhe shëndeti;
- Ekonomia familjare;
- Karriera;
- Media;

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Komunikues efektiv:

I.1 Lexon qartë me zë një tekst letrar apo joletrar, të palexuar me parë.

I.2 Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) ose më shumë për një temë të caktuar.

I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

I.8 Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta, duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

Mendimtar kreativ:

II.1 Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse.

II.4 Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria

ose fusha të tjera dhe jep një shembull ose më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.

II.5 Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.

Nxënës i suksesshëm:

III.1 Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes.

III.2 Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.

III.3 Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shënjuar me shenja të ndryshme).

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.

III.5 Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.

III.7 Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.

III.9 Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Komunikues produktiv:

IV.2 Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetet më me prioritet, duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre.

IV.3 Përgatit një projekt të vogël, duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupon atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.

IV.4 Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.

Individ i shëndoshë:

V.2 Merr pjesë në aktivitete fizike-lojëra lëvizore dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer, menaxhon emocionet e veta dhe prezanton para të tjerëve gjendjen fizike dhe shpirtërore pas realizimit të një aktivitet fizik apo loje sportive.

V.7 Dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata të caktuara të rrezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor.

V.8 Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/ shkolle apo jashtë saj).

Qytetarë i përgjegjshëm:

VI.7 Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrethit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet-mënyra e të ushqyerit, menaxhimi i ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimmarrja në familje etj.) ose disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

- 1.1 Përshkruan ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bëhen individualisht dhe në grup.
- 1.2 Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetëiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar produkte të ndryshme punëdore, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim.
- 2.1 Demonstron gatishmëri dhe vetëiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet, duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup.
- 4.1 Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare.
- 4.2 Përdor i-e sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike.
- 5.1 Drejtpërdrejt hulumton dhe përfshihet në aktivitete të ekonomisë familjare dhe ushtron përgjegjësi elementare organizative-buxhetore, duke zhvilluar shpirtin e ndërmarrësit.
- 6.1 Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.
- 7.1 Demonstron përmes veprimeve të veta nevojën për marrjen e përgjegjësive, ndarjen e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, shkollë dhe komunitet.
- 9.1 Përpunon materiale ricikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtëse për ruajtjen e mjedisit.
- 9.2 Zhvillon njohuri dhe shkathtësi për shoqërinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë familjare dhe përdorimin e TIK-ut.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Mjedisi dhe shëndeti (1 orë)	Krijon projekt për aktivitetet sipas kalendarit mjedisor përmes kompjuterit. Analizon detyrat, përgjegjësitë e menaxhimit të shtëpisë.	3.5 Punë praktike 4.1 Ekonomia Familjare 4.2 Roli i menaxherit të shtëpisë	20 orë	Mësimdhënia dhe të nxënësve me nxënës në qendër dhe gjithëpërfshirja	Buletini i Pjesëmarrjes • Lista e Kontrollit • Portofoli i Nxënësit • Vlerësim i Ndërsjellë • Semafori	Njeriu dhe Natyra • Gjuhë shqipe • Edukatë Figurative • Edukatë muzikore • Edukarta fizike, sporte dhe shëndeti	Teksti shkollor Broshura, Enciklopedi, Softuerë arsimorë, Materiale dhe mjete të ndryshme pune për punë praktike. https://www.google.com/search?q=mbrojtja+e+mjedisit https://www.google.com/search?q=menaxhimi+n%C3%AB+familje https://www.pinterest.com/pin/238550111486545605/
Ekonomia familjare (8 orë)	Përshkruan si realizohet menaxhimi shtëpiak përmes detyrave praktike.	4.3 Menaxheri i Shtëpisë		Mësimdhënia dhe të nxënësve e bazuar në arritjen e kompetencave			
Karriera (5 orë)	Hulumton në internet forma të ndryshme të menaxherit të shtëpiak	4.4 Shembuj të menaxherit të shtëpiak		Mësimdhënia dhe të nxënësve e integruar	• Dy yje - një Dëshirë • Vetëvlerësim	• Shoqëria dhe Mjedisi • Matematikë	https://www.google.com/search?q=mbrojtja+e+mjedisit https://www.google.com/search?q=menaxhimi+n%C3%AB+familje
Media (6 orë)	- Paraqet pjesët kryesore të shtëpisë ekonomisë familjare, duke analizuar dhe llogaritur buxhetin familjar në elemente të ndryshme. - Krijon planin familjar për menaxhimin e	4.5 Llogaritja e buxhetit familjar 4.6 Plani familjar 4.7 Punë praktike		Punë në grupe Punë në çift Punë individuale Rruga imagjinare DRTA	• Vlerësimi i punës praktike	• Çështjet Ndërkurrikulare • Zhvillimi personal dhe shkathësi për jetë	

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
	shpenzimeve mujore. - Krijon veshje, paketime, pajisje (makete) të ndryshme nga materialet ricikluese. - Paraqet përmes videoe/fotove, rrugën e karrierës së prindit apo familjarëve të tij. - Tregon hobin dhe imagjimon përshatjen e tij me profesionin e preferuar. - Dallon llojet e profesioneve të ndryshme. - Harton një miniplan për shkathtësitë/afësitë e tij/ saj. - Liston ide të ndryshme lidhur me karrierën. - Organizon aktivitete shkollore sipas ideve të grupit, incizimi, prezantimi e postimi	-Test 5.1 Rruga e karrierës 5.2 Profesionin i ëndrrave 5.3 Llojet e profesioneve dhe veçoritë e tyre 5.4 Planifikimi i karrierës 5.5 Procesi i orientimit të karrierës 6.1 Roli i medias në jetën shkollore 6.2 Zhvillimi i aftësive ndërmarrëse		Stuhi mendimesh Turi i galerisë Vizualizimi Pyetje binare Ditari dypjesësh Di/dua të di/mësova Copëza të përziera Mësimdhënia e ndërsjellët Harta e konceptit Kubimi Projekt Hulumtim		Edukim për zhvillim të qëndrueshëm	https://www.google.com/search?q=rruga+e+karrier%C3%ABs&rlz https://www.google.com/search?q=menaxhimi+n%C3%AB+familje https://mileniumi3.net/orientimi-ne-karriere/ https://www.canva.com/posters/ https://www.stardewvalley.net/

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
	në faqet e shkollës dhe mediat lokale. • Organizon aktivitete dhe gara të ndryshme që paraqesin veprime ndërmarrëse (p.sh., gara për fotografi, vizatime, krijime të ndryshme etj.). • Përdor lojëra të ndryshme kompjuterike me sens ndërmarrës. • Plotëson tabelat ku përcaktohen nevojat dhe shpenzimet në familje, duke përdorur programe kompjuterike. • Fotografon dhe mbledh shenjat sinjalizuese të rrezikut dhe mbrojtjes në punë, si dhe i vendos në tabelat e shkollës	6.3 Lojëra kompjuterike për të nxitur aftësitë ndërmarrëse 6.4 Shpenzimet në Familje 6.5 Shenjat sinjalizues -Test					

Kapitulli 1

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare:/Lënda: Shkathësi për jetë Shkalla e kurrikulës: 2/Klasa V Jeta dhe puna	
Tema: Shkathësi për jetë - punëdore	Rezultati i të nxënit të temës: Dallon materialet ndërtimore (argjila, gipsi, çimentoja, stiropori, mermeri, graniti, kaolini);
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : I.1,3; II.1,6,8; III.9.	
Rezultatet e fushës së kurrikulës : 1.1,2.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 1.1 Materialet ndërtimore	
Fjalët kyçe: <i>material ndërtimor, konstruktion, argjila, kaolina, mermeri</i>	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: • diskuton me shokun në krah dhe shkruan njohuritë që ka për materialet ndërtimore; • analizon tekstin me ndalesa; • u përgjigjet saktë pyetjeve të shtruara.	
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja, në bashkëpunim me nxënësit në klasë.	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti, fletorja, fotografi, ilustrime, objekte të ndërtuara me materialet në fjalë.	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyraArsimi për zhvillim të qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Hapi 1 Mësuesi/ja mund ta nisë orën me pyetjet e aktivitetit të parë që janë në librin e nxënësve, apo të fillojë me aktivitetin si më poshtë. Paraqet temën para nxënësve, u kërkon të diskutojnë në çift dhe të shkruajnë çfarë dinë për të.	

Materialet ndërtimore

Nxënësit kanë kohë pesë minuta për të shkruar çfarë dinë për materialet ndërtimore. Një çift prej secilit grup paraqet para klasës njohuritë paraprake për materialet ndërtimore.

Hapi 2

Pasi nxënësit njihen me temën dhe rezultatet, caktojnë kriteret e suksesit të orës mësimore, vazhdojnë me leximin e përmbajtjes nga ana e nxënësve. Përmes teknikës “Stilolapsi në mes”, përzgjidhet nxënësi/ja që lexon paragrafin në vijim. Nxënësi/ja që lexon pjesën e caktuar, duhet të bëjë sqarimin e asaj që ka lexuar, të shtrojë pyetje rreth përmbajtjes dhe t’u përgjigjet pyetjeve që i shtrojnë nxënësit rreth pjesës në fjalë. Njësoj veprohet me paragrafët e tjerë.

Hapi 3

Pasi nxënësit kanë marrë informacionet e duhura, u kërkohet që, në grup, të provojnë veten, duke iu përgjigjur pyetjeve me informacionet e reja për materialet. Secili grup prezanton para klasës përgjigjet e kërkesës së detyrës.

Provo veten:

1. Cilat kanë qenë materialet ndërtimore që njerëzit kanë përdorur në kohët e lashta?
2. Tregoni disa materiale ndërtimore që gjenden në natyrë.
3. Sillni shembuj të përdorimit të argjilës në ndërtimtari.
4. Sillni shembuj të përdorimit të kaolinës dhe mermerit në banesën tuaj.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësohen për analizën e tekstit, si dhe për bashkëpunimin në çift dhe në grup.

Detyrat e shtëpisë

Gjej shembuj në shtëpi të objekteve/gjërave të ndërtuara me materialet që mësuat.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Fusha kurrikulare:/Lënda:** Shkathësi për jetë **Shkalla e kurrikulës:** 2/Klasa V

Jeta dhe puna

Tema: Shkathësi për jetë - punëdore	Rezultati i të nxënit të temës: Dallon materialet ndërtimore (argjila, gjipsi, çimentoja, stiropori, mermeri, graniti, kaolini);
---	--

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës :I.1,3; II.1,6,8; III.9.**Rezultatet e fushës së kurrikulës :**1.1,2.**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: 1.2 Materiale të tjera ndërtimore

Fjalët kyçe: *material ndërtimor, konstruktion, graniti, gjipsi, çimento, stiropori***Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**

- Flet për paranjohuritw lidhur me materialet ndërtimore;Sqaron përmbajtjen e paragrafit të lexuar; Plotëson saktë tabelën me njohuritë e reja për materialet e mësuara.

Kriteret e suksesit:

I plotëson mësuesi/ja, në bashkëpunim me nxënësit në klasë.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti, fletorja, fotografi, ilustrime, objekte të ndërtuara me materialet në fjalë (filxhan, tjegull,, gur, copë stiropori etj.)**Lidhja me lëndët e tjera mësimore:**

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyraArsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**Hapil**

Ora fillon me diskutimin rreth kërkesës së detyrave të shtëpisë. Nxënësit diskutojnë për shembujt që kanë sjellë në klasë (qoftë në mënyrë të shkruar, apo që kanë sjellë gjësend të ndërtuar me materiale të mësuara orë më parë). Pas diskutimit u kërkohet nxënësve të shohin me kujdes fotografinë në libër dhe t'u përgjigjen pyetjeve në tekst.

Aktivitet

- Shikoni me vëmendje objektin e paraqitur në figurë. Me çfarë materialesh është ndërtuar ai?
- Përmendni emrat e disa materialeve ndërtimore që njihni.
- Cili prej tyre mendoni se është më i fortë për ndërtim?

Diskutim i përbashkët në mënyrë frontale.

Hapi 2

Hapen librat dhe njihen nxënësit me temën dhe rezultatet e të nxënësve që do të arrihen. Lexohet teksti nga ana e nxënësve, i ndarë në paragrafë. Nxënësi që lexon paragrafin jep sqarime rreth pjesës së lexuar, u përgjigjet pyetjeve të shtrëna nga nxënësit e tjerë, si dhe bën pyetje rreth sqarimeve që ka dhënë. Në këtë mënyrë, veprohet edhe me paragrafë të tjerë, me nxënës të ndryshëm.

Hapi 3

Pasi nxënësit kanë marrë informacionet e duhura, u kërkohet që, në grup, të provojnë veten, duke plotësuar tabelën me informacionet e reja për materialet.

Argjila	Kaolina	Mermeri	Graniti	Gjipsi	Cimentoja	Stiropori

Hapi 4

Secili grup prezanton punimin e tij në mënyrë frontale.

Vlerësimi i nxënësve

Buletini i pjesëmarrjes

Detyrat e shtëpisë

Fletore pune f. 5, 6

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Shkathësi për jetë - punëdore		Rezultati i të nxënit të temës: Hulumton zbatimin e materialeve ndërtimore (projekt individual).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1,3; II.1,6,8; III.1,9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.2; 2.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 1.3 Përdorimi i materialeve ndërtimore			
Fjalët kyçe: pllaka, tulla, tjegulla, llaç, gur, suvatim			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: - vëzhgon me kujdes materialet që janë përdorur në ndërtimin e mjediseve ose objekteve. - plotëson saktë kërkesën e detyrës për temën e caktuar. - krahason detyrën e punuar dhe e diskuton në grup.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, fletorja, fotografi, ilustrime, objekte të ndërtuara me materialet në fjalë (filxhan, tjegull, gur, copë stiropori etj.)			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra. Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Aktivitet: Nxënësit bashkë me mësimezhënësin/en kryejnë një shëtitje të shkurtër nëpër mjediset të ndryshme brenda shkollës ose jashtë saj. Ata vëzhgojnë me kujdes materialet që janë përdorur në ndërtimin e mjediseve ose objekteve që vizitohen. Pasi kthehen në klasë, hapet diskutimi rreth vëzhgimit të materialeve ndërtimore që janë përdorur për ndërtimin e objektit.			
Hapi 2 Nxënësit njihen me temën dhe rezultatet e të nxënit të orës mësimore dhe caktojnë kriteret e suksesit në bashkëpunim me mësuesin/en. Në vazhdim, mësuesi/ja i ndan nxënësit në grupe dhe secilit grup i ofron nga një detyrë si në vijim:			

Grupi 1
Muri



Grupi 2
Shkallët



Grupi 3
Dyshemeja



Grupi 4
Çatia



Grupi 5
Tavani



Udhëzohen nxënësit që secili grup të plotësojnë kërkesat e detyrave (në librin e nxënësve) për temën e caktuar. Krahësojnë në çift detyrën e punuar dhe diskutojnë në grup përgjigjet e dhëna. Hulumto në internet informacione shtesë (nëse është e mundur në klasë) për zbatimin e materialeve ndërtimore dhe paraqiti para klasës.

Hapi 3

Punohet në fletore pune f. 7, 8.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Buletini i pjesëmarrjes

Detyrë shtëpie

- Listo materialet ndërtimore me të cilat është ndërtuar shtëpia/banesa ku jeton.
- Sillni në klasë objekte të ndryshme prej argjile, kaolini, gjipsi, stiropori.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore


ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Shkathësi për jetë - punëdore		Rezultati i të nxënit të temës: Krahason vetitë e materialeve (argjila, gjipsi, çimentoja, stiropori, mermeri, graniti, kaolini).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1,3; II.1,6,8; III.1,9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.2; 2.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 1.4 Vetitë e materialeve ndërtimore			
Fjalët kyçe: veti, fortësi, ngjyrë, qëndrësë, peshëhiqet			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: - dallon vetitë e materialit përmes aktivitetit. - eksperimenton në praktikë vetitë e materialit ndërtimor. - krahason përfundimet e nxjerra për secilin material ndërtimor.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësve, objekte të ndryshme prej argjile, kaolini, gjipsi, stiropori, ujë, prerëse.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: - Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra. - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Aktivitet “Gjej çfarë fshihet në kuti” (Vendosen objekte të ndryshme në kuti/qese. Përmes prekjes, nxënësit dallojnë materialin e objektit) - Çfarë objekti zbuluat? - Si e dalluat? - Nga se është i ndërtuar? - Përshkruaj vetitë e tij të dukshme. - Krahaso dy objekte; ku ngjasojnë dhe si ndryshojnë? Përmes diskutimit, arrijmë te vetitë e materialeve.			

Hapi 2

Njihen nxënësit me temën që do të trajtohet. Secilit grup i caktohet pjesa që duhet lexuar dhe analizuar para klasës (bëhet në mënyrë zinxhir prej paragrafit të parë dhe në vazhdim). Pasi të jenë informuar për materialin ndërtimor/vetinë/zbatimin, nxënësit plotësojnë tabelën, duke iu përgjigjur pyetjeve të shtruar.

Hapi 3**Punë praktike 1**

Plotëso tabelën me përgjigjet e pyetjeve dhe emrat e materialeve ndërtimore.

Pyetje	Përgjigje	Lloji i materialit ndërtimor	
A digjen tjegullat nga rrezet e diellit?			     
A e depërton ujin tulla?			
A digjet stiropori?			
A digjet tjegulla nga zjarri?			
A thyhet tjegulla nga ngricat?			
A digjet pllaka prej graniti?			
A e depërton ujin pllaka prej mermeri?			
A e përcjell elektricitetin porcelani?			
A e depërton ujin filxhanti?			
A digjet tulla nga zjarri?			
A e depërtojnë ujin tjegullat?			

Pasi nxënësit të kenë plotësuar tabelën, hapet diskutimi për punën e bërë, duke krahasuar dhe duke dhënë argumente për përgjigjet e paraqitura.


- Provoni t'i thyeni objektet me dorë, duke i përkulur. Cili u thyet?
- Me prerëse, provoni të prisni objektet prej argjile, porcelani, gjipsi dhe stiropori. Cili u pre? A la prerësi shenjë në objekt?
- Hidhni ujë mbi objektet prej argjile, porcelani, gjipsi dhe stiropori. Cili prej tyre e thith ujin? A e prishin formën materialet?
- Çfarë kuptuat nga puna praktike në klasë?

VLERËSIMI I NXËNËSVE
<i>Buletini i pjesëmarrjes</i>
Detyrë shtëpie
(Sugjerohet aktivitet jashtëkurrikular: vizitë te një punishte që lëndë të parë ka argjilën/gjipsin apo çimenton.)
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE					
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna		Lënda: Shkathësi për jetë		Shkalla e kurrikulës: 2	
Klasa: V					
Tema: Shkathësi për jetë - punëdore			Rezultati i të nxënësve të temës: Krahason vetitë e materialeve (argjila, gjipsi, çimentoja, stiropori, mermeri, graniti, kaolina).		
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1,3; II.1,6,8; III.1,9.					
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.2; 2.1					
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE					
1.5 Njësia mësimore: Veprimtari praktike					
Fjalët kyçe: veti, fortësi, ngjyrë, qëndrueshmëri, peshë					
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore: - dallon vetitë e materialit përmes aktivitetit. - eksperimenton në praktikë vetitë e materialit ndërtimor. - argumenton përfundimet e nxjerra për secilin material ndërtimor.					
Kriteret e suksesit: i plotëson mësuesja/si në bashkëpunim me nxënësit në klasë.					
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, objekte të ndryshme prej argjile, kaolinë, gjips, stiropori, ujë, prerëse					
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm					
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE					
Hapi 1					
Hapet diskutim për materialet e sjella në klasë (argjilë, kaolinë, gjips, stiropor).					
Pasi thonë njohuritë paraprake për materialet, ata nxjerrin përfundimet për vetitë e tyre përmes pyetjeve të shtrënuara në libër, si:					
-Provoni t'i thyeni objektet duke i përkulur me dorë. Cili prej tyre thyhet?					
- Tani, provoni të prisni me prerëse objektet prej argjile, porcelani, gjipsi dhe stiropori.					
a) Cili prej tyre u pre?					
b) A la shenjë prerësi në objekt?					
- Hidhni ujë mbi objektet prej argjile, porcelani, gjipsi dhe stiropori.					
a) Cili prej tyre e thith ujin?					
b) A e prishin formën materialet?					
Hapi 2					
Pasi të kenë vërtetuar përmes eksperimentit vetitë e materialit, ata plotësojnë tabelën në librin e nxënësit me informacionet e marra.					
Objekti		Argjilë		Kaolinë	
Pyetje				Gjipsi	
				shkumës	
A pritët?				jo	
A la shenjë prerësi?				po	
A u thye me dorë?				po	
A përthith ujin?				po	
A ndryshoi formë?				jo	

Hapi 3

Nxënësit vazhdojnë punën praktike në grupe, duke vepruar me materialet në dispozicion për të nxjerrë përfundime:



- Cila nga masat e përfutuara u ngurtësua më shpejt?
- Si mendoni, a mund të rikthehen përsëri në pluhur masat e përfutuara?
- Argumentoni përgjigjen tuaj.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Buletini i pjesëmarrjes

Detyrë shtëpie

Sugjerohet aktivitet jashtëkurrikular, vizitë e një punishteje ku lëndë të parë ka argjilën/gjipsin apo çimenton.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Shkathësi për jetë - punëdore ndërtimore (argjilë, gjips, stiropor)		Rezultati i të nxënit të temës: Zhvillon shkathësitë, duke përdorur pajisje të thjeshta teknike për punimin e projekteve me materiale të ndryshme	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; III.4.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.2.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: 1.6 Krijime me materiale ndërtimore

Fjalët kyçe: punë praktike, shprehje pune, krijim, produkt

Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore:

- Hulumton në internet shembuj për punimin e objekteve me materiale ndërtimore.
- Punon një objekt duke u bazuar në udhëzimet e dhëna.
- Prezanton punimin e bërë para klase.

Kriteret e suksesit:

I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: dorezë plastike, prerës, pluhur gjipsi (allçi) ose pluhur çimentoje, ujë, enë plastike (tas, kovë e vogël), lugë druri, spango.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Art figurativ.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE**Hapi 1**

Ora fillon me hulumtim në internet, shembuj për punimin e objekteve me materiale ndërtimore, si: me gjips (allçi), ose çimento. Nxënësit ndjekin hapat e të punuarit me materialin në fjalë (nëse është realizuar aktiviteti jashtëkurrikular i propozuar në orën e kaluar, nxënësit do t'i kenë njohuritë nga vëzhgimi dhe do ta kenë më të lehtë. Nëse jo, atëherë nxënësit orientohen në hulumtimin në internet) dhe arrijnë në përfundimin se hapat kryesorë të punës janë:

**Hapi 2**

Hapat kryesorë të punës janë:

- Përgatitja e vendit të punës dhe e mjeteve të punës
- Përzgjedhja e materialit (gjips, çimento)
- Studimi i detyrës
- Përgatitja e masës së lëngët
- Hedhja në formë
- Nxjerrja nga forma
- Prezantimi i projektit



(Nxënësit mund të bëjnë përzgjedhjen e objektit që u pëlqen për ta punuar, apo ta punojnë shembullin si në libër.)

Hapi 3

Mësuesi/ja ofron udhëzime (demonstron njëkohësisht) që nxënësit ta realizojnë me sukses punën praktike në klasë.

Udhëzime

Përgatitja e masës së lëngët:

- Në enën plastike përziejme pluhurin me ujin (duke përdorur lugën e drurit) derisa të përftohet një masë homogjene e cila të rrjedhë lehtësisht nga ena.

Hedhja e masës së lëngët në dorezë:

- Mbajeni grykën e dorezës të hapur;
- Derdheni me kujdes masën brenda formës;
- Kujdes! Mbusheni formën njëtrajtësisht!
- Lidheni grykën e dorezës me spango.
- Lëreni derisa masa të forcohet.
- Me prerës, hiqni dorezën duke e prerë pjesë-pjesë.
- Lëreni të thahet.

Prezantimi: Dorën mund ta lyeni dhe ta zbukuroni sipas dëshirës. Më pas, vendosni unazat nëpër gishta dhe kryeni prezantimin.

Hapi 4

Gjithashtu, nxënësit orientohen në shprehitë që duhet të kenë gjatë punës, si:

Shprehi të punës:

- Përgatitja e vendit për punë
- Përdorimi i veshjeve mbrojtëse (doreza, maska, syze)
- Përgatitja e materialeve dhe e mjeteve për punë
- Durimi dhe kujdesi në punë
- Pastrimi i vendit të punës

Bëhuni kreativë

- *Objekti i krijuar në këtë projekt mund të prezantohet duke e dekoruar dorën si pemë me degë me lule dhe me gjethe.*
- *Ky projekt mund të realizohet edhe për të krijuar objekte të tjera (p.sh. një vazo me lule), duke përdorur si forma, gota plastike të riciklueshme.*

Hapi 5

Pasi kanë marrë njohuritë dhe udhëzimet si duhet punuar objekti në fjalë, nxënësit në grupe fillojnë punën praktike. Punimet e nxënësve prezantohen në klasë, si dhe mund të shfrytëzohen për ekspozitat që organizon shkolla në raste të ndryshme, apo mund të prezantohen te “Mbledhja e prindërve për prezantimin e projekteve”.

VLERËSIMI I NXËNËSVE
<i>Lista e vëzhgimit</i> <i>Vlerësimi i ndërsjellë</i> <i>Vlerësimi i produktit</i>
Detyrë shtëpie
Shkruaj në fletore çfarë mësove.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Kapitulli 2

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathhtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Puna me projekte përmes TIK-ut - krijimi i <i>crafts</i>		Rezultati i të nxënit të temës: Tregon ecurinë e krijimit të një projekti në TIK me <i>crafts</i> .	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; III.2,4,9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1,2; 4.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 2.1 Projektet e punëdoreve në TIK			
Fjalët kyçe: projekt, dizajn, <i>crafts</i> , programe kompjuterike			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: • diskuton me shokun në krah njohuritë që kanë për projektet e bëra më parë; • analizon tekstin e lexuar me ndalesa; • krijon në bashkëpunim planin e projektit me temën që përzgjedh.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, fletore pune, ilustrime, kompjuter.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Art figurativ, Ed. Fizike. Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi: 1 Aktivitet: Ora mësimore fillon me një lojë, në të cilën nxënësit lëvizin lirshëm nëpër klasë. Mësuesi/ja shkruan në tabelë kërkesën: • <i>Sillni ndërmend projektet që keni krijuar me punëdore.</i> • <i>Kujtoni cilët kanë qenë hapat që keni ndjekur.</i>			

Në momentin kur mësuesi/ja jep komandën: “STOP!”, nxënësit kapen në dyshe përballë njëri-tjetrit dhe shkëmbejnë mendime rreth kërkesës. Në përfundim, mësuesi/ja pyet:

- Çfarë kujtuat me shokun/shoqen?
- Çfarë vështirësish keni hasur?
- Sa kohë ju është dashur për realizimin e projektit?

Hapi 2

Hapen librat dhe njihen nxënësit me temën dhe rezultatet e të nxënësve që do të arrihen. Lexohet teksti nga ana e nxënësve, i ndarë në paragrafë. Nxënësi që lexon paragrafin jep sqarime rreth pjesës së lexuar, u përgjigjet pyetjeve të shtruara nga nxënësit e tjerë, si dhe bën pyetje rreth sqarimeve që ka dhënë. Në këtë mënyrë, veprohet edhe me paragrafët e tjerë, me nxënës të ndryshëm.

Hapi 3

Pasi të analizohet teksti dhe ilustrimet dhe të sqarohet ecuria e krijimit të një projekti me *crafts*, mësuesi/ja shtron pyetjet:

- Cilat janë pikat e planit që duhet të keni parasysh gjatë krijimit të një projekti?
- Si mund t'i përdorim mjetet TIK në një projekt me *crafts*?
- Jepni mendimin tuaj në lidhje me projektet individuale dhe ato në grup.

Hapi 4

Në vazhdim, nxënësit punojnë punë praktike në fletoren e punës f. 9, 10.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Buletini i pjesëmarrjes

Detyrë shtëpie

Plotëso trungun familjar, sipas planit të projektit.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathhtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Puna me projekte përmes TIK-ut - krijimi i <i>crafts</i>		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan fazat e krijimit dhe prezantimit të një projekti përmes TIK-ut.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.8; III.2,4,9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1,2; 4.2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 2.2 Krijimi dhe prezantimi i projektit përmes TIK-ut			
Fjalët kyçe: krijim, prezantim, mjete të TIK-ut, softwer, program kompjuterik, aplikacion, mjete digjitale			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: - Tregon mjetet e TIK-ut që ka përdorur për të realizuar një projekt. - Analizon tekstin sipas rolit të caktuar. - Plotëson saktë detyrën e dhënë.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: burime nga interneti, kompjuter, projektor (mjete të ndryshme digjitale, çfarë mund të sigurohet)			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze. Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Pasi orën e kaluar nxënësit kanë mësuar si të krijojnë pemën e familjes me punëdore, hapet diskutimi në klasë se cilat mjete të TIK-ut mund t'i ndihmonin për një prezantim sa më të bukur të punimit. U kërkohej nxënësve të tregojnë disa nga mjetet e TIK-ut që kanë përdorur gjatë realizimit të projekteve.			
Hapi 2 Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekste në dyshe. Roli i parë është roli i raportuesit , i cili lexon pjesën me kujdes dhe përgatitet të përmbledhë përmbajtjen e asaj pjese. Pasi ta lexojë pjesën e vet, ai i tregon partnerit të tij për përmbajtjen e pjesës. Roli i dytë është ai i përgjegjedhënesit . Edhe përgjegjedhënesit lexojnë pjesën dhe dëgjojnë me kujdes raportuesin. Kur të mbarojë raportuesi, përgjegjedhënesi i bën pyetje raportuesit, për të sqaruar leximin. Në vazhdim, dyshet sjellin para klase përfundimet e nxjerra.			

Teksti ndahet në dy pjesë:

1. Përdorimi i TIK-ut në projektet e punëdoreve
2. Krijimi i një albumi nëpërmjet programit *Google Photos*

(Mësuesi/ja ndërkohë prezanton me projektor mjetet e TIK-ut që u trajtuan)

Hapi 3

Pasi kanë analizuar tekstin, kanë diskutuar në mënyrë frontale dhe kanë parë në projektorë mjetet e TIK-ut, nxënësit udhëzohen të plotësojnë rubrikën “Provo veten”.

Krijoni një album me fotografi, duke përdorur aplikacionin *Google Photo*. Kombinoni disa fotografi në një faqe dhe shtoni tekst të veçantë, për të krijuar albumin, të cilin mund ta shpërndani me të afërmit tuaj duke klikuar komandën *Share*.

Hapi 4

Disa punime të nxënësve diskutohen para klase.

Në vazhdim, nxënësit ndahen në çifte dhe punojnë fletoren e punës, f. 11.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për analizën e tekstit.

Vlerësohen për bashkëpunimin.

Vlerësohen për saktësinë e plotësimit të detyrës së dhënë.

Detyrë shtëpie


Plotëso fletoren e punës, f. 12.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Puna me projekte përmes TIK-ut - krijimi i <i>crafts</i>		Rezultati i të nxënit të temës: Përdor programe kompjuterike për krijimin e modeleve, siç janë: origami, <i>crafts</i> për punëdore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.8; III.2,4,9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1,2; 3.2; 4.2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 2.3 Krijimi i modeleve përmes programeve kompjuterike			
Fjalët kyçe: program, origami. Just Origami, Origami Editor 3D			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: - Tregon përvojat e punëdores me letër. - Krijon një raketë prej letre duke u bazuar në udhëzime. - Analizon përdorimin e dritares së programit <i>Origami 3D Editor</i>. - U përgjigjet saktë pyetjeve të shtruara.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: burime nga interneti (https://sourceforge.net/projects/origamieditor3d/), kompjuter, projektor, objekte të punuara me letër, letër			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Matematikë, Art figurativ. Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Mësimdhënësi/ja i ofron secilit grup nga një objekt të punuar me letër, si: raketë, kapelë, zarf (pliko) dhe shtron pyetjet: - Çfarë keni para vetes? - Nga se është e ndërtuar? - Si është ndërtuar? - A keni ndërtuar ndonjëherë objekte të tilla? (Diskutim)			

Hapi 2

Aktivitet: Merr një copë letër katrore dhe, nëpërmjet teknikave të palosjes, përpiku të formosh një raketë prej letre, si në figurë. Mbaj mend hapat që ndoqe. Më pas, hape letrën dhe vështro vijat e palosjes së letrës. Diskuto në klasë për vështirësitë që hase. Si mendon, a ka mjete digjitale që mund të na ndihmojnë në krijimin e modeleve të tilla?

**Hapi 3**

Pas diskutimit, nxënësit njihen me artin e origamit. Lexohet teksti me ndalesa, duke u ofruar nxënësve informacionet e duhura. Më pas, nxënësit udhëzohen të analizojnë dhe të mbajnë shënime në organizuesin grafik për informacionet kyçe.

Origami	Përdorimi i programit kompjuterik në krijimin e origamit	Programi Just Origami	Programi Origami Editor 3D


Duke u bazuar në informacionet kyçe të shënuara në organizuesin grafik, nxënësit bëjnë përmbledhjen e tekstit që është lexuar.

Hapi 4

Mësimdhënësi/ja praktikon programin para nxënësve duke dhënë shembuj të përdorimit të tij.

(Për të shkarkuar programin, fillimisht duhet të keni instaluar programin *Java* në kompjuter.

Programi *Origami Editor 3D* mund të shkarkohet falas, në këtë lidhje: <https://sourceforge.net/projects/origamieditor3d/>

**Hapi 5**

- Nxënësit vazhdojnë me punën praktike në fletoren e punës, fq.13,14. Punimet e tyre ekspozohen në klasë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE
<i>Buletini i pjesëmarrjes</i>
Detyrë shtëpie
Praktiko në internet programin Origami dhe sill përvojën në klasë.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathhtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Puna me projekte përmes TIK-ut - krijimi i <i>crafts</i>		Rezultati i të nxënit të temës: Modelon forma të ndryshme me <i>crafts</i> përmes skicave dhe modeleve që gjenden në internet.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.8; III.2,4,9;			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1; 3.2, 4.2;			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 2.4 Veprimtari praktike			
Fjalët kyçe: punë praktike, palosje, shpalosje, krijim, origami i pinguinit			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: • Vepron saktë, sipas hapave të caktuar për krijimin e origamit. • Krijon pinguinin e plotë përmes artit të origamit. • Sqaron përvojën e tij gjatë punës praktike.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti: https://origami.me/ , kompjuter, projektor, letër, laps me ngjyrë të ndezur.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Matematikë, Art figurativ. Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
(Këtë mësim, do të këshillojmë ta zhvillojmë në kabinetin e informatikës. Nëse nuk është e mundur, duhet të përdorni fletë të bardha dhe mundësisht, një laps me ngjyrë të ndezur, që ta keni më të lehtë për të vizatuar vendin ku do të bëhet palosja.)			
Hapi 1 Njihen nxënësit me punën praktike që do të realizojnë dhe me rezultatet e të nxënit për orën mësimore. Duke u bazuar në udhëzimet e detajuara në libër, duhet të veproni si më poshtë: Shkruaj në motorët e kërkimit: https://origami.me/ . Në faqen e saj, kliko butonin: Search for diagrams Shfaqet një koleksion i ndarë në kategori: Kafshët (<i>Animals</i>), Zogjtë (<i>Birds</i>), Peshqit (<i>Fish</i>) dhe Krijesat e detit (<i>Fish and sea creatures</i>), Dinozaur etj. Zgjidh modelin e kërkuar, në këtë rast, një pinguin.			

Ndiq udhëzimet për të përfituar origamin e një pinguini. (Nëse po e përdor për herë të parë këtë aplikacion, të këshillojmë të ndjekësh udhëzimet e dhëna në Udhëzuesin për fillestarë ***Beginner's Guide***, i cili ju tregon të gjitha teknikat bazë.)

Hapi 2

Duke ndjekur modelin, nxënësit udhëzohen të veprojnë sipas hapave në vijim. Pasi të kenë ndjekur dhjetë hapat e veprimit, ata do të kenë krijuar pinguinin duke u bazuar në programin Origami.

Punimet e nxënësve ekspozohen në murin e klasës dhe ata diskutojnë bashkërisht për përvojat e tyre gjatë punës.

Hapi 3

Udhëzohen nxënësit të krijojnë një origami që t'i shërbejë mësimit të lëndës "Njeriu dhe natyra".

Nxënësit hulumtojnë figura të ndryshme që ofron programi dhe i punojnë ato.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet puna praktike.

Detyrë shtëpie

Krijo objekte të ndryshme me artin e origamit dhe silli ato në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathhtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Puna me projekte përmes TIK-ut - krijimi i <i>crafts</i>		Rezultati i të nxënit të temës: Krijon projekte shkollore me programe kompjuterike me fokus në punëdore (<i>crafts</i> , origami).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.8; III.2,4,9;			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1,2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 2.5 Projekt			
Fjalët kyçe: origami, vizore, maus, projekt			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: • Prezanton para klase objektet e origamit të punuara në shtëpi. • Projekton në kompjuter figura origami, duke përdorur veglat që ofron programi. • Diskuton për përvojat gjatë realizimit të projektit.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: burime nga interneti (https://origami.me/), kompjuter, projektor. Sqarim:Për të shkarkuar programin fillimisht duhet të keni instaluar programin Java ne kompjuter. Programin Origami Editor 3D mund të shkarkohet falas në këtë lidhje: https://sourceforge.net/projects/origamieditor3d/			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Matematikë, Art figurativ. Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Ora fillon me prezantimin e objekteve të krijuara përmes artit të origamit nga nxënësit në shtëpi edhe në klasë. U kërkohet të sqarojnë hapat e veprimit për krijimin e origamit. Nxënësit japin sqarime para klase dhe i vendosin punimet e tyre në murin e projekteve.			
Hapi 2 Nxënësit njihen me punën praktike (përdorimi i programit OrigamiEditor 3D nga ana e tyre) që do të realizojnë dhe me rezultatet e të nxënit për orën mësimore. Fillimisht, të gjithë nxënësit së bashku me mësuesin/en (mundësisht, secili nxënës të ketë kompjuter), bëjnë në të njëjtën kohë hapat në programin			

Origami Editor 3D. Duke e demonstruar, mësuesja i njeht nxënësit me veglat e programit, të cilat i përdorin edhe nxënësit në kompjuterët e tyre. Domethënë, sqarohen veglat e punës në program, si: përdorimi i vizores dhe funksioni i mausit.

Hapi 3

Pasi nxënësit praktikuan përdorimin e vizores dhe mausit, udhëzohen të krijojnë varkën nëpërmjet programit Origami Editor 3D, duke i ndjekur 11 hapat e veprimit siç janë të sqaruara në libër, gjithmonë nën vëzhgimin e mësuesit/es.



Hapi 4

Në kohën e mbetur, nxënësit vazhdojnë në fletoren e punës, f. 15-17

(Sqarim: Njësia mësimore 2.5 Projekt, ka të planifikuara dy orë mësimore. Orën e dytë vazhdohet projekti në fletoren e punës, f. 18-22)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen shkathhtësitë e përdorimit të programit Origami.

Vlerësohet realizimi me sukses i projektit.

Detyrë shtëpie

Praktikojë programin Origami Editor 3D në shtëpi dhe silli përvojat në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Kapitulli 3

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathhtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Mjedisi dhe shëndeti		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon diversitetin individual në klasë, në shkollë dhe në komunitet, duke përdorur praktika të mira për zgjidhjen e konflikteve.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.8; IV.3; V.8; VI.3			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 8.1; 9.2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 3.1 Diversiteti individual			
Fjalët kyçe: Diversitet, diferencim, paragjykim, diskriminim			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: - Parashikon temën, duke u bazuar në ilustrim. - Veçon informacionet, përmes shenjave përkatëse. - Analizon gjetjet në bashkëpunim. - Diskuton për diversitetin dhe për qëndrimin e tij/saj për situata të ndryshme.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, teksti, organizuesi grafik, mjete TIK-u.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Edukimi për paqe.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Aktivitet: Parashikim, duke u bazuar tek ilustrimi Paraqitet ilustrimi në sfond (burim nga interneti) dhe u kërkohet nxënësve të parashikojnë përmbajtjen e temës që do të trajtohet, duke u bazuar tek ilustrimi. - Çfarë mendoni kur shihni këtë ilustrim? - Pse mendoni ashtu? Argumentoni.			

Udhëzohen nxënësit të mbyllin sytë dhe në heshtje të dëgjojnë fjalët e mësuesit/es: “Imagjinoni si do të ishte bota sikur të gjithë të visheshim njësoj, të hanim të njëjtat ushqime, të flisnim të njëjtën gjuhë, të silleshim në të njëjtën mënyrë”.

(Për një minutë, nxënësit qëndrojnë të heshtur që të imagjinojnë.)

- Si e imagjinuat?
- Çfarë ju erdhi në mendje?
- A do të ishte një botë e bukur dhe interesante? Pse?



Hapi 2

Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin dhe gjatë leximit, të vendosin shenjat e mëposhtme në tekst:

- Vendosni shenjën “√” (kontrollo), nëse diçka që lexoni, pohon atë që dini ose mendoni se dini.
- Vendosni një “+” (plus), nëse një pjesë e informacionit që ndeshni, është i ri për ju.
- Vendosni një “-” (minus), nëse një ose disa prej informacioneve që lexoni, kundërshton ose është i ndryshëm nga ajo që dini ose mendoni se dini.
- Vendosni një “?” (pikëpyetje), nëse ka informacion që është i paqartë për ju ose duhet të dini më shumë rreth këtij informacioni.

Informacioni i shenjzuar hidhet më pas në tabelën INSERT, sipas shenjave përkatëse.

“√”	“+”	“-”	“?”

Analizohen të dhënat që kanë paraqitur nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga ana e mësuesit/es apo nxënësve.

Shtrohen pyetje rreth dy situatave të paraqitura në libër:

- Çfarë mendoni për qëndrimin e Ilirit në situatën e parë?
- A ka të drejtë të mendojë në atë mënyrë? Pse mendoni ashtu?
- Cili është qëndrimi juaj?
- Çfarë mendoni për situatën e dytë?
- Çfarë do të bëje ti, që ai të mos ndihej i mënjanuar?
- Cilat parime duhen respektuar për të krijuar një mjedis paqësor në klasë, shkollë dhe komunitet?

Hapi 3

Pasi është analizuar teksti, realizohet rubrika: **Provo veten.**

- Çfarë kupton me *diversitet*?
- Përse nuk duhet ta paragjykojmë njëri-tjetrin?
- Diskuto me shokët dhe shoqet rreth një situatë të pakëndshme që mund të ketë ndodhur në klasë apo në shkollë. Çfarë ke bërë ti si nxënës/e për të zgjidhur konfliktin e krijuar?

Hapi 3

Në vazhdim ndërtohet mozaiku në fletoren e punës, f. 23.

VLERËSIMI I NXËNËSVE
<i>Buletini i pjesëmarrjes gjatë analizës së tekstit. Të menduarit në mënyrë kritike në përgjigjet e dhëna.</i>
Detyrë shtëpie
Krijo një pamflet me mesazhe pozitive për diversitetin.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathhtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Mjedisi dhe shëndeti		Rezultati i të nxënit të temës: Hulumton diversitetin ekologjik në mjedisin jetësor në internet.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.8; IV.4,8; VI.4,6.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 8.1; 9.2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 3.2 Diversiteti ekologjik			
Fjalët kyçe: ekologji, diversitet ekologjik, mjedis, botë e gjallë, përshtatje, ngrohje globale			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: - Krahason diversitetin individual me atë ekologjik. - Analizon tekstin, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve. - Përmbledh tekstin, duke u bazuar në fjalët kyçe.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: burime nga interneti (fotografi apo video), teksti, mjete TIK-u.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu e natyra, Edukimi për paqe.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Udhëzohen nxënësit të bëjnë lidhjen mes asaj që është mësuar orë më parë (diversitetin individual) dhe ilustrimit që shohin.			
- Çfarë mund të thoni për ilustrimin nëse e lidhim me njohuritë që kemi marrë në mësimin e kaluar? - Çfarë kuptoni me fjalën <i>ekologji</i>? Si mendoni, me çfarë ka lidhje ajo? - A ka diversitet në botën shtazore? - Jepni disa shembuj. (Në këtë mënyrë, arrijnë te tema mbi diversitetin ekologjik.)			

Hapi 2

Lexohet teksti me ndalesa. Pas secilës ndalesë, pasojnë pyetjet:

- Çfarë kuptoni me fjalën ekologji?
- Si ndërvepron ekologjia me mjedisin? (Sqaro)
- Si ndikon ndryshimi i klimës te gjallesat?
- Cilët janë shkaktarët e ndryshimeve klimatike? Pse?
- Çfarë karakteristikash kanë shtazët, që i ndihmojnë të mbijetojnë në habitatet e tyre? (Tregojnë shembujt që janë trajtuar.)
- Po për bimësinë, çfarë mund të thoni?
- Cilat janë arsyt që kanë çuar te ngrohja globale?
- Si ka ndikuar ngrohja globale te mjedisi ku jetojnë gjallesat?
- Çfarë iniciativash janë marrë për mbrojtjen e mjedisit?
- Cili është qëndrimi juaj për këtë çështje?
- Çfarë mendoni për Greta Thunbergun?
- Çfarë mund të bëjmë ne për këtë çështje?

Hapi 3

Pasi të jetë analizuar teksti në mënyrë të detajuar, udhëzohen nxënësit që në grup të bëjnë një përmbledhje të informacionit duke u bazuar në fjalët kyçe si më lart. Njëri anëtar i grupit lexon përmbledhjen që kanë punuar në bashkëpunim.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për analizën e tekstit.

Buletini i pjesëmarrjes gjatë punës në grup.

Detyrë shtëpie

Plotëso fletoren e punës, f. 25, 26

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Mjedisi dhe shëndeti		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon ndikimin negativ të mbetjeve të pazbërthyeshme në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; III.1; IV.4.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 9.2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 3.3 Ndotja e mjedisit dhe shëndeti			
Fjalët kyçe: ndotje, mbetje të pazbërthyeshme, ndotja e ajrit			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: - Diskuton për pasojat e mbetjeve në komunitetin ku jetojmë. - Tregon njohuritë paraprake për temën. - Shtron pyetje rreth tekstit të lexuar. - Përmbledh njohuritë e reja në tabela. Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja, në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: burime nga interneti https://www.google.com/search?q=mbrojtja+e+mjedisit (fotografi apo video), teksti, mjete TIK-u			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu e natyra, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Udhëzohen nxënësit si më poshtë: Shkruani 5 fjalë që ju vijnë në mendje kur themi “mbetje të pazbërthyeshme”. Jepni mendimin tuaj si mund të ndikojnë këto mbetje në komunitetin ku jetoni. Diskutoni në çift e pastaj në grup rreth problemeve që shkaktajnë ato në mjedis. (Diskutim i përbashkët në mënyrë frontale.)			
Hapi 2 Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin, duke plotësuar tabelën “Di/Dua të di/Mësova” - Në kolonën e parë, “Di”, nxënësit do të shkruajnë atë informacion që iu duket i njohur nga leximi. - Në kolonën e dytë, “Dua të di”, do të shkruhen pyetje ose kërkesa të nxënësve rreth çështjeve për të cilat ata kërkojnë të dinë më tepër. - Në kolonën e tretë, “Mësova”, nxënësit do të shkruajnë një përmbledhje të informacionit të ri që përvetësuan nga teksti. (Mësuesi/ja jep sqarimet eventuale që nuk janë thënë dhe gjithashtu, ofron informacione shtesë, foto/video, burime nga interneti.)			

Hapi 3

Pasi të jetë analizuar teksti, nxënësit diskutojnë rreth rubrikës “Provo veten”, duke iu përgjigjur pyetjeve si më poshtë:

- Cilat janë shkaqet e ndotjes së mjedisit?
- Pse mbetjet plastike janë shumë të dëmshme për mjedisin?
- Si e kuptoni shprehjen: “Duke mbrojtur mjedisin, mbrojmë shëndetin tonë”?
-

Hapi 4

Në vazhdim, nxënësit punojnë në fletoren e punës, f. 27, 28 në mënyrë individuale dhe i diskutojnë punimet e tyre para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Plotësimi i tabelës dhe sqarimet e dhëna

Detyrë shtëpie

Hulumto në internet për pasojat e ndotjes së mjedisit dhe sill informacionet në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Mjedisi dhe shëndeti		Rezultati i të nxënit të temës: Liston ditët ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,3; II.6; III.4; V.8.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 9.2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 3.4 Kalendar mjedisor			
Fjalët kyçe: kalendar mjedisor, ditë ndërkombëtare, mbrojtja e mjedisit, aktivitet, kontribut			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: - Diskuton në mënyrë frontale për mbrojtjen e mjedisit. - Analizon tekstin në bashkëpunim me grupin. - Përmbledh në tabelë informacionet e marra.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: burime nga interneti (fotografi apo video), teksti, organizues grafik, mjete TIK-u			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu e natyra, Edukimi për paqe. Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Aktivitet: Mjedisi është “shtëpia” e secilit prej nesh. Për këtë arsye, të gjithë duhet të japim kontributin tonë për mbrojtjen e tij. Si mendoni, çfarë duhet të bëjmë për ta pakësuar sa më shumë ndotjen e mjedisit? Diskutoni me njëri-tjetrin rreth kësaj problematike dhe jepni mendime për zgjidhjen e saj. (Diskutim i hapur në klasë.)			
Hapi 2 Analizohet paragrafi i parë i “Kalendar mjedisor” me bashkëpunimin e mësuesit/es me nxënësit. Në vazhdim, ndahen nxënësit në grupe dhe secili grup udhëzohet të analizojë një datë të shënuar. Grupi i parë: 21 mars- Dita Ndërkombëtare e Pyjeve Grupi i dytë: 22 mars – Dita Ndërkombëtare e Mbrojtjes së Ujit Grupi i tretë: 22 prill – Dita Ndërkombëtare e Tokës Grupi i katërt: 5 qershor – Dita Botërore e Mjedisit Grupi i pestë: 22 shtator - Dita Botërore e Lëvizjes pa Makina Grupi i gjashtë: 4 tetor – Dita Botërore për Mbrojtjen e Kafshëve			

Secili grup ka bërë analizën e paragrafit, duke shkruar të dhënat në fletën A4 dhe i vendosin punimet në një kënd të klasës. Një anëtar i grupit bën prezantimin e punës. Pasi nxënësit informohen për secilën datë të shënuar me qëllim mbrojtjen e mjedisit, udhëzohen të bëjnë përmbledhjen në fletoret e tyre apo organizues grafik që u ofron mësuesi/ja. (Mund të orientohen në këndin ku janë vendosur punimet e grupeve.)

21 mars - Dita Ndër-kombëtare e Pyjeve	22 mars – Dita Ndër-kombëtare e Mbrojtjes së Ujit	22 prill – Dita Ndër-kombëtare e Tokës	5 qershor – Dita Botërore e Mjedisit	22 shtator - Dita Botërore e Lëvizjes pa Makina	4 tetor – Dita Botërore për Mbrojtjen e Kafshëve

Hapi 3

Në fund, punohet rubrika “Provo veten”, ku nxënësit u përgjigjen pyetjeve të shtruar.

1. Përse shërben kalendari mjedisor?
2. Cilat janë aktivitetet që zhvillohen në shkollën tënde për mbrojtjen e mjedisit?
3. Si mendon, përse janë të rëndësishme kafshët? Çfarë duhet të bëjmë për mbrojtjen e tyre?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për punën në grup.

Analizën e tekstit.

Përmbledhjen e informacioneve.

Detyrë shtëpie

Plotëso në fletore pune fq. 29, 30

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Mjedisi dhe shëndeti		Rezultati i të nxënit të temës: Krijon projekt për aktivitetet sipas kalendarit mjedis-or përmes kompjuterit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II.2,3,6; III.2,4,9; IV.3,4; VI.6.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.2; 9.2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 3.5 Punë praktike			
Fjalët kyçe: mbrojtja e kafshëve, qyteti pa makina, mbrojtja e mjedisit.			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: - Jep ide për planin e projektit që do ta punojnë në bashkëpunim. - Reflekton për gjetjet gjatë javës, për aktivitetet në ditët e shënuara për mbrojtjen e mjedisit. - Planifikon brenda grupit aktivitetet jashtë klase (jashtëkurrikulare) për realizimin e projektit.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: letra A3, kompjuter, internet, CD me dokumentarë, enciklopedi, video/projektor, ngjyra.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu e natyra, Arsime për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Njoftohen nxënësit se qëllimi i këtij mësimi është që nëpërmjet aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit të japin kontributin e tyre në shoqëri, shkollë dhe komunitet.			
Hapi 2 Bëhet ndarja e nxënësve në dy grupe. Tema e grupit të parë: Krijoni një poster me temë: Dita Ndërkombëtare për Mbrojtjen e kafshëve Hapat që do të ndjekësh: - Krijo planin e projektit (në programin Word) me ndihmën e mësuesit/es. - Hulumto në internet dhe mblidh informacionin e nevojshëm për realizimin e projektit. - Përpuno informacionin që more (shkruaje ose printoje në fletë A4, duke e shoqëruar me fotografite përkatëse). - Prezantoje në klasë posterin e krijuar, në një fletë të madhe formati A3. Në të njëjtën mënyrë jepen udhëzimet edhe për grupin e dytë, duke iu referuar informacioneve në libër.			

Hapi 3

Udhëzohen nxënësit të reflektojnë mbi gjetjet në internet gjatë javës së kaluar (ishte detyrë gjatë javës) për aktivitetet që zhvillohen në ditët e shënuara për mbrojtjen e mjedisit. Përqendrohemi tek aktiviteti “Qyteti pa makina”, duke u bazuar në libër.

- Çfarë do të ndryshonte në mjedis, nëse do t'i përdornim sa më pak makinat?
- Po në shëndetin tonë, si do të ndikonte një nismë e tillë? Pse?

Pasi kanë diskutuar dhe kanë marrë ide, nxënësit fillojnë planifikimet brenda grupit gjatë orës, për të vazhduar më tutje me aktivitete jashtëkurrikulare (vizita, hulumtime...) gjatë javës, që secili grup të realizojë projektin e tij.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për bashkëpunimin.

Vlerësohen për marrjen e përgjegjësi.

Vlerësohen për planifikimet e duhura (jashtëkurrikulare) që bëjnë në grup.

Detyrë shtëpie

Bashkëpunim në grup për realizimin e projektit.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Kapitulli 4

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathhtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Ekonomia familjare		Rezultati i të nxënit të temës: Tregon konceptet kryesore të ekonomisë familjare përmes shembujve të jetës së përditshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; II.1,4; III.4.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.1; 5.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 4.1 Ekonomia familjare			
Fjalët kyçe: ekonomi familjare, nevoja dhe dëshira, burime, mallra, shërbime, prodhues, konsumator, mjete monetare			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: - Gjen kuptimin e shprehjes “Ekonomi familjare” përmes lojës. - Analizon tekstin me ndalesa. - Argumenton konceptet kryesore të ekonomisë, përmes shembujve nga jeta e përditshme.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja, në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, fletorja, fotografi, ilustrime			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra. Çështjet ndërkurrikulare: Globalizimi dhe ndërvarësia			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Jepen udhëzimet e lojës “Shkojmë në piknik” Ndahen nxënësit në grupe me nga 4 nxënës që përfaqësojnë një familje. - Si do ta organizoni piknikun? - Kush do ta bëjë organizimin e piknikut? - Cilat janë shpenzimet? - Kush do t’i menaxhojë shpenzimet? (Përmes lojës, nxënësit arrijnë te koncepti i ekonomisë familjare.)			

Më pas, nxënësit u përgjigjen pyetjeve të shtruar në librin e tyre, si:

- A ju pëlqen të luani Monopoly, Game of Life ose Mine-craft? (Këto lojëra janë sa të këndshme, aq edhe të dobishme, pasi ju mësojnë shumë gjëra nga fusha e ekonomisë.)
- Si do ta përkufizonit termin “ekonomi”?

Hapi 2

Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin me ndalesa ku, çdo ndalesë pasohet nga pyetjet:

Ndalesa e parë

- Çfarë kuptuat nga ajo që lexuat?
- Çfarë kuptimi ka shprehja ekonomi familjare?
- Bëj një krahasim të nevojave parësore me ato dytësore.
- Cilat janë nevojat tuaja parësore/dytësore?
- Nga se varet plotësimi i nevojave?
- Cilat janë burimet njerëzore/materiale?

Ndalesa e dytë

Para se të lexohet paragrafi i radhës, udhëzohen nxënësit të krahasojnë dy ilustrimet në libër.

- Shiko ilustrimet dhe gjej dallimin. (Diskutim)


Pasi nxënësit arrijnë të kuptojnë që në ilustrimin e parë ka mallra, ndërsa në ilustrimin e dytë shihen shërbimet që bëjnë njerëzit, atëherë lexojnë paragrafin.

Udhëzohen nxënësit të diskutojnë në grup dhe të argumentojnë përgjigjen.

- Si mendoni, cilës kategori i përket ndërtuesi: asaj të mallrave apo të shërbimeve? Pse? Po fermeri dhe klientët që blejnë produktet e tij, në cilat kategori bëjnë pjesë? Argumentoni përgjigjen.

Ndalesa e tretë

- Kush janë prodhuesit?
- Keni prodhuar ju ndonjë gjë? Argumento (vizatim, gatim...).
- Po konsumator, kë quajmë?
- Çfarë veprimesh bën një njeri që të jetë konsumator?
- Jeni ju konsumatorë? Pse?



Udhëzohen nxënësit të diskutojnë në çift dhe të komentojnë në grup kur janë njëkohësisht, prodhues dhe konsumatorë.

- Në të shumtën e rasteve, prodhuesit janë edhe konsumatorë. Për shembull, një shitës akulloresh është prodhues i këtij produkti dhe njëherësh konsumator, pasi ai blen qumështin, sheqerin dhe përbërësit e tjerë për të prodhuar akullloren. Përmendni disa shembuj të tillë, ku prodhuesi të jetë njëkohësisht konsumator.

Hapi 3

Nxënësit udhëzohen që të plotësojnë rubrikën “Provo veten” dhe të diskutojnë kërkesat e rubrikës në mënyrë frontale.

1. Plotëso tabelën.

Nevojat që kam	
Dëshirat e mia	

2. Përshkruaj ndryshimin midis mallrave dhe shërbimeve.

3. Ç’kupton me termin konsumator?

Hapi 4

Nxënësit punojnë punë praktike në fletore pune, f. 31, 32.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Analiza e tekstit

Diskutimi në klasë

Detyrë shtëpie

Fletore pune, f. 33,24

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Ekonomia familjare		Rezultati i të nxënit të temës: Analizon detyrat, përgjegjësitë e menaxherit të shtëpisë	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; II.1,4; III.4.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1; 4.1,2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 4.2 Roli i menaxherit të shtëpisë			
Fjalët kyçe: menaxher i shtëpisë, administrim, mbikëqyrje, udhëheqje.			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: 1. Shkruan çfarë di për konceptin e dhënë. 2. Analizon tekstin në bashkëpunim. 3. Veçon njohuritë e reja në organizuesin grafik. 4. Arsyeton para klase detyrën e bërë.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja, në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, kompjuteri, organizuesi grafik, fotografi, ilustrime			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi.			
Çështjet ndërkurrikulare: Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Shtron pyetjen mësuesi/ja: Çfarë kuptoni me fjalën menaxher? Menaxher			
Nxënësit, për pesë minuta, shkruajnë paranjohuritë që kanë për konceptin dhe të gjitha të dhënat shënohen në tabelë.			
Hapi 2 Shpeshherë, kur dëgjojmë fjalën “menaxher”, përfytyrojmë dikë që kujdeset për mbarëvajtjen e punës në një biznes. Po në familjen tuaj, kush e luan një rol të tillë? (Diskutim frontal)			

Bëhet leximi i tekstit (pjesa e parë) dhe analiza duke veçuar nxënësit, me shenjën plus për gjërat që dinë dhe minus, për gjërat që nuk i dinë në lidhje me rolin dhe detyrat e menaxherit (diskutim për gjetjet, jepen sqarimet e nevojshme).

Udhëzohen nxënësit që të bëjnë leximin në bashkëpunim (në grup), duke shënuar të dhënat në tabelë (nëse është e mundur përmes TIK-ut, apo tabelën ua ofron mësuesi/ja) ku njëri anëtar i grupit përmes “Stilolapsit në mes” jep sqarime para klase.

Organizimi	Komuni- kimi	Delegimi	Menaxhimi i kohës	Adminis- trimi	Udhëheqja	Roli i nënës në menax- himin e shtëpisë

Hapi 3

Në pjesën e fundit të orës, nxënësit reflektojnë në mënyrë individuale, duke plotësuar rubrikën “Provo veten” dhe e paraqesin reflektimin para klase.

- Qarko detyrat që kryen menaxheri i shtëpisë.
 - Mbikëqyr dhe kujdeset për anëtarët e familjes.
 - Punon gjithë kohës në kompjuter.
 - Menaxhon buxhetin e shtëpisë.
- ç) Jep veç urdhra dhe udhëzime.
 - Kujdeset vetëm për pagesën e faturave të ujit dhe të energjisë elektrike.
 - Ndan detyrat në familje.
 - Gatuan vetëm në fundjavë.
 - Diskuton me anëtarët e familjes dhe bashkërendon punët me ta.
- Po në familjen tënde, cili është menaxheri i shtëpisë? Përshkruaj disa nga detyrat e tij.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Buletini i pjesëmarrjes.

Bashkëpunimi në grup.

Plotësimi i detyrës në mënyrë individuale.

Detyrë shtëpie

Diskuto me prindërit për mënyrën e menaxhimit në familje, vështirësitë/përparësitë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Ekonomia familjare		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan si realizohet menaxhimi shtëpiak përmes detyrave praktike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; II.1,4; III.4.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 5.1; 9.2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 4.3 Menaxhimi i shtëpisë			
Fjalët kyçe: pastrim, planifikim, organizim.			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: - Zbulon fjalën/fjalinë duke u bazuar në lëvizjet e shokut/shoqes. - Sqaron pjesën e lexuar pa gabime. - Përmbledh tekstin, duke u bazuar në termat e dhënë.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, organizuesi grafik, fotografi, ilustrime.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë fizike.			
Çështjet ndërkurrikulare: Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Luhet loja me pantomima, ku fjalët që duhen zbuluar kanë të bëjnë me punët e shtëpisë. Ndahen nxënësit në dy grupe dhe loja organizohet në formë gare, ku grupi që zbulon më shumë fjalë, është grupi fitues. Në këtë mënyrë, nxënësit arrijnë të temën që do të trajtohet.			
Hapi 2 Shtrohen pyetjet: - Cilat janë detyrat që ju kanë caktuar prindërit për mirëmbajtjen e shtëpisë? - A i kryeni ato siç duhet? Diskutoni me njëri-tjetrin në klasë. Nxënësit orientohen që të tregojnë përvojat nga jeta e përditshme rreth mirëmbajtjes së shtëpisë.			
Hapi 3 Teksti ndahet në paragrafë dhe nxënësit në çift analizojnë pjesën e caktuar. Pasi lexojnë paragrafin dhe e diskutojnë në çift, përfundimet e nxjerra i paraqesin para klase. Çifti duhet të japë sqarime, t'u përgjigjet pyetjeve të shtrura nga shokët/shoqet në klasë dhe në fund, t'u shtrojë pyetje nxënësve rreth paragrafit të trajtuar. Për secilën pjesë të lexuar, veprohet në të njëjtën mënyrë.			

Hapi 4

Shënohen në tabelë nëntituajt që kishin paragrafët (pastrimi, planifikimi dhe përgatitja e vaktit, organizimi, planifikimi/kalendari, kujdesi për fëmijët, menaxhimi financiar, aktivitetet familjare, kujdesi për kafshët). Udhëzohen nxënësit që të bëjnë në grup (shkurtimisht) një përmbledhje të asaj që u tha. Njëri anëtar i grupit lexon punimin e bërë. (Diskutim i përbashkët)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për saktësinë gjatë lojës (sqarimet gjatë pantomimës).

Analiza dhe sqarimet e dhëna për paragrafin.

Përmbledhja e tekstit duke u bazuar në termat e dhënë.

Detyrë shtëpie

Krijo me ndihmën e prindërve një plan kalendari, ku të shënosh detyrat që do të kryejë gjatë javës secili nga anëtarët e familjes. Shëno me tik në kalendar detyrën që është kryer dhe me X, detyrën e pakryer. Zbulo cila ka qenë arsyeja pse nuk është kryer ajo.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathhtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Ekonomia familjare		Rezultati i të nxënit të temës: Hulumton në internet forma të ndryshme të menaxhimit familjar dhe kursimeve kryesore të shtëpisë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,3; III.3; IV.2			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.2; 5.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 4.4 Shembuj të menaxhimit shtëpiak			
Fjalët kyçe: menaxhim shtëpiak, planifikim, kalendar, kursim.			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: - Hulumton në internet forma të ndryshme të menaxhimit familjar. - U përgjigjet saktë pyetjeve të shtruara. - Shkruan për detyrat që mund të kryejë në shtëpinë e tij/saj. - Krijon një listë me kursimet që do të bëjë për të ulur shpenzimet e familjes.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja, në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: burime nga interneti https://www.google.com/search?q=menaxhimi+n%C3%AB+familje, teksti, organizuesi grafik .			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Udhëzohen nxënësit të hulumtojnë në internet forma të ndryshme të menaxhimit familjar (nëse nuk është e mundur, atëherë këtë e bën mësuesi/ja). Diskutim i përbashkët rreth gjetjeve.			
Hapi 2 Shtrohet pyetja: Nëse në një periudhë të caktuar, familja juaj është në vështirësi financiare dhe i duhet të kursejë, si do të vepronit për ta ndihmuar? Diskutoni në klasë. Bëhet leximi i tekstit në mënyrë zinxhir ku gjatë analizës, nxënësit e lidhin me përvojat e tyre në jetën e përditshme. - Sa kontribuoni ju në menaxhimin e shtëpisë? - Në çmënyrë kontribuoni? - Si i organizoni punët e shtëpisë në familjen tuaj? Pasi nxënësit lexojnë paragrafin e radhës, arrijnë në përfundimin se për menaxhimin e mirëfillt të shtëpisë, duhet të planifikohen dhe organizohen detyrat për secilin nga anëtarët e familjes, duke u bazuar në pikat që paraqiten në planifikim, si më poshtë.			

Vazhdohet me leximin e tekstit në mënyrë zinxhir, duke bërë analizën e tekstit përmes pyetjeve të shtruara:

- Si menaxhohet buxheti familjar? (Duke kursyer)
- Cilat janë mënyrat e të kursyerit?
- Si vepron ju me rrobat që nuk ju nevojiten më?
- Po rryma, uji dhe karburantet në ç'mënyrë duhen kursyer?
- E bëni një gjë të tillë në shtëpitë tuaja? Si?

Hapi 3

Pasi të kenë analizuar dhe diskutuar rreth tekstit, nxënësit udhëzohen të shkruajnë në mënyrë individuale rreth rubrikës “ Provo veten”.

1. Cilat janë detyrat që mund të kryesh në shtëpinë tënde?
2. Krijo një listë me kursimet që do të bëje për të ulur shpenzimet e familjes.

Pasi të kenë përfunduar shkrimet, shkëmbejnë punimet e tyre në çift, vlerësojnë njëri-tjetrin dhe shkëmbejnë ide për ndërhyrjet e nevojshme. Punimet e nxënësve vendosen në një kënd dhe lexohen para klase, duke dalluar idetë e përbashkëta dhe ato të veçanta të çifteve. Diskutim i përbashkët.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Analiza e tekstit.

Vlerësimi i ndërsjellë.

Detyrë shtëpie

Plotëso fletore pune fq. 35, 36

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Ekonomia familjare		Rezultati i të nxënës të temës: Paraqet pjesët kryesore të ekonomisë familjare, duke analizuar dhe llogaritur buxhetin familjar në elemente të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; III.3,4; IV.2; VI.7.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1; 5.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 4.5 Llogaritja e buxhetit familjar			
Fjalët kyçe: buxhet familjar, të ardhura, shpenzime, kursime			
Rezultati/et i të nxënës për orë mësimore: - Diskuton për shpenzimet e tij/saj javore. - Sqaron në detaje njohurit e marra për ekonominë familjare. - Llogarit shpenzimet dhe kursimet sipas kërkesës në detyrë.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, organizuesi grafik (tabelë, nëse është i realizueshëm përdorimi i kompjuterit), fotografi, ilustrime.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi, Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 <i>Aktivitet:</i> Udhëzohen nxënësit të bëjnë llogarinë e shpenzimeve që bëjnë gjatë një jave. Për pesë minuta nxënësit bëjnë një llogari të përafërt të shpenzimeve të tyre javore. Nxënësit udhëzohen të bëjnë krahasimin e shpenzimeve të tyre në çift e pastaj në grup dhe punimet i paraqesin para klase. Diskutojnë për ngjashmëritë dhe ndryshimet e vlerave. - Pse shoku/shoqja ka më pak shpenzime? - Si mund ta bëni edhe ju një gjë të tillë? - A mund t'i reduktojmë shpenzimet? Si?			
Hapi 2 Diskutim i përbashkët: A ju ka ndodhur ndonjëherë që keni kërkuar të blini diçka dhe prindërit nuk kanë mundur t'ju plotësojnë dëshirën?			

- Si keni reaguar?
- Si mendoni, përse nuk kanë mundur?

Në këtë mënyrë, arrijmë te buxheti familjar dhe bëhet leximi i tekstit i ndarë në paragrafë. Nxënësi që lexon paragrafin para klase duhet të japë sqarime rreth paragrafit që ka lexuar, t'u përgjigjet pyetjeve të shtruara nga nxënësit dhe në fund, t'u shtrojë pyetje nxënësve rreth paragrafit që ka trajtuar para tyre.

Një gjë e tillë përsëritet edhe me paragrafët e tjerë nga nxënësit e tjerë (teksti ndahet në katër paragrafë: Buxheti. Pse është i rëndësishëm buxheti? Nga se përbëhet buxheti? Si bëhet buxheti?).

Hapi 3

Udhëzohen nxënësit që të zgjidhin në mënyrë individuale detyrën e rubrikës “Provo veten”.

- Prindërit i japin Valonit 20 € në javë. Ai shpenzon çdo ditë 2,5 € për drekën në mensën e shkollës dhe 50 cent, për transportin. Valoni dëshiron shumë të blejë një biçikletë, e cila kushton 130 €. Llogaritni buxhetin e Valonit. Sa euro shpenzon në javë? Sa i mbeten? A i dalin ato për të blerë biçikletën? Nëse nuk i dalin, sa javë duhet të presë Valoni që të blejë biçikletën?

Përmes teknikës “Stilolapsi në mes”, nxënësit përzgjedhin prej secilit grup për të paraqitur zgjidhjen e detyrës para klase.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i ndërsjellë.

Analiza e tekstit.

Buletini i pjesëmarrjes.

Detyrë shtëpie

Plotëso në fletore pune fq. 37, 38

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathhtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Ekonomia familjare		Rezultati i të nxënit të temës: Krijon planin familjar për menaxhimin e shpenzimeve mujore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; III.3,4,9; VI.7.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1; 5.1; 9.2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 4.6 Plani familjar			
Fjalët kyçe: plani familjar, shpenzime fikse, shpenzime të ndryshueshme.			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: - Tregon për kursimet e bëra gjatë javës. - Analizon tekstin për të veçuar informacionet e reja. - Krijon një plan të ndarë me përqindje shpenzimesh për familjen e tij/saj.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, organizuesi grafik (tabelë, nëse është i realizueshëm përdorimi i kompjuterit), fotografi, ilustrime.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi, Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Diskutim rreth kursimeve që kanë arritur të bëjnë gjatë javës (detyrë shtëpie dhënë në orën e kaluar). - Nëse do të bëni një listë me sendet që dëshironi të blini, cilat do të vinit në krye të saj? - Si mendoni, çfarë duhet të keni parasysh gjatë hartimit të kësaj liste? Pse? Përmes diskutimit, arrijmë te tema që do të trajtohet.			
Hapi 2 Udhëzohen nxënësit që përmes leximit në heshtje, të lexojnë tekstin dhe të shkruajnë për informacionet shtesë (nxënësit mund të reflektojnë njohuri nga orët e mëparshme) që trajtohen në këtë njësi mësimore rreth planit familjar. Në këtë mënyrë, nxënësit arrijnë të veçojnë informacionet dhe t'i lidhin ato me jetën e përditshme. Nxënësit diskutojnë në grup për të vazhduar pastaj me diskutime para klase. - Cilat janë informacionet që morët nga teksti? - Si duhet vepruar nëse shpenzimet janë më të mëdha se të ardhurat? - Cilat janë llojet e shpenzimeve? (fikse/të ndryshueshme) Nxënësit kategorizojnë shpenzimet që janë të përshtatshme për familjet e tyre (p.sh. heq/vendos, kredinë/qiranë... etj.).			

Shpenzime fikse	Shpenzime të ndryshueshme

(Nëse është e mundur, organizuesin grafik nxënësit mund ta plotësojnë përmes TIK-ut.)

- Ku duhet të mbështetemi për t'i administruar sa më mirë të ardhurat dhe për të patur një plan familjar?

Hapi 3

Pasi nxënësit thonë udhëzimet për krijimin e një plani familjar dhe pasi kanë analizuar ndarjen e shpenzimeve sipas kategorive siç janë në libër, udhëzohen të bëjnë në klasë një ndarje të tillë, të përafërt (duke u bazuar në shpenzimet fikse dhe ato të ndryshueshme që kanë punuar, si më lart) për familjet e tyre.

Pasi të kenë përfunduar detyrën, punimet i vendosin në një kënd në klasë (turi i galerisë). Nxënësit i shohin punimet e njëri-tjetrit dhe i diskutojnë ato.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për informacionet e veçuara.

Analiza e tekstit.

Puna individuale.

Detyrë shtëpie

Rubrika “Provo veten” duhet të punohet në shtëpi në bashkëpunim me prindërit.

- Me ndihmën e prindërve, bëj një plan për shpenzimet mujore të familjes. Listo shpenzimet fikse dhe ato të ndryshueshme dhe përcakto për secilin shpenzim një shumë të caktuar parash.
- Ndaj në përqindje shpenzimet dhe shiko rezultatin. Si mendon, a ke bërë ndarjen e duhur?

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathhtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Ekonomia familjare		Rezultati i të nxënit të temës: Krijon veshje, paketime, pajisje (maketa) të ndryshme nga materialet e riciklueshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.4; IV.3.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2; 4.2; 9.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 4.7 Punë praktike: Krijime me materiale të riciklueshme			
Fjalët kyçe: materiale të riciklueshme, maket, produkt			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: - Hulumton në internet mbi përdorimin e materialeve të riciklueshme për krijimin e objekteve. - Krijon një objekt me materiale të riciklueshme duke u bazuar tek udhëzimet. - Eksponon punimin duke dhënë sqarime për punën praktike.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, TIK-u, fotografi, ilustrime, gota plastike, kapëse letrash, tela, ngjitës në trajtë shiriti të tejdukshëm, katër shkopinj të hollë (nga ata që përdoren në kuzhinë).			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi, Art figurativ. Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë; Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Udhëzohen nxënësit të hulumtojnë në internet rreth përdorimit të materialeve të riciklueshme për krijimin e objekteve. Diskutohet rreth informacioneve që kanë gjetur. Njoftohen nxënësit se gjatë kësaj ore mësimore do të krijojnë sende të ndryshme me materiale të riciklueshme. Mësuesi/ja i orienton nxënësit në shembullin që është në libër dhe i informon për detyrat kryesore, siç janë: - Përgatitja e vendit të punës dhe e mjeteve të nevojshme - Përzgjedhja e materialit - Shqyrtimi i hapave që do të ndiqen - Ndërtimi i bazës së llambadarit - Ndërtimi i trupit - Prezantimi i punimit (maketit)			

Hapi 2

Mësuesi/ja ofron materialet dhe nxënësit të ndarë në grupe përgatisin vendin e punës dhe mjetet e nevojshme të ofruara nga mësuesi/ja. Në vazhdim, mësuesi/ja demonstroi para nxënësve punën praktike duke u bazuar në sqarimet e dhëna në librin e nxënësve hap pas hapi. Gjithashtu, mësuesi/ja vendos në sfond (projektor/TV <https://www.pinterest.com/pin/238550111486545605/>)

video apo instruksionet për punën praktike gjatë orës në vazhdim. Nxënësit, në bashkëpunim, fillojnë punën praktike nën vëzhgimin e mësuesit/es.

Hapi 3

Pasi të kenë përfunduar punimet, ata i paraqesin para klase duke komentuar punimin që ka bërë, kënaqësitë që u ka dhuruar puna praktike dhe vështirësitë e mundshme gjatë punës.

(Vlen të theksohet se ndërtimi i llambadart mund të bëhet me përmasa më të vogla apo të krijohet diçka më e thjeshtë. Një gjë të tillë e vendos vetë mësuesi/ja i klasës.)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Buletini i pjesëmarrjes.

Puna praktike.

Detyrë shtëpie

Krijo me materiale të riciklueshme një objekt (mbajtës lapsash, kuti shkumësash...) duke u bazuar te gjetjet në internet.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Kapitulli 5

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Karriera		Rezultati i të nxënit të temës: Paraqet përmes videove/fotove, rrugën e karrierës së prindit apo familjarëve të tij.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; III.2; IV.3.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 5.1 Rruga e karrierës			
Fjalët kyçe: karrierë, profesion, aftësi, shkathësi.			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: 1. Parashikon duke u bazuar në titull dhe ilustrim. 2. Analizon tekstin duke dhënë sqarime. 3. Përpilon një projekt, duke u bazuar në pyetjet e shtruara.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja, në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti (https://www.google.com/search?q=rruga+e+karrier%C3%ABs&rlz), teksti, organizues grafik për projektin.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Udhëzohen nxënësit të bëjnë parashikim duke u bazuar te titulli dhe tek ilustrimi që paraqet mësuesi/sja në sfond (burim nga interneti).		Rruga e karrierës	
- Çfarë mendoni, kur shikoni titullin dhe ilustrimin? - Pse e mendoni këtë? - Keni menduar ju për karrierën tuaj? - Cilën rrugë do të zgjidhni ju? - Çfarë ju shtyn? Pse?			

Hapi 2

Nxënësit njihen me temën dhe në bashkëpunim me ta, caktohen kriteret e suksesit për njësinë mësimore. Lexohet nga ana e nxënësve teksti i ndarë në paragrafë. Nxënësi që lexon paragrafin, jep sqarime rreth pjesës së lexuar, u përgjigjet pyetjeve të shtruara nga nxënësit e tjerë, si dhe bën pyetje rreth sqarimeve që ka dhënë. Në këtë mënyrë, veprohet edhe me paragrafët e tjerë, me nxënës të ndryshëm. Pasi të jetë analizuar përmbajtja, mësuesi/ja shton se, për më shumë informacione, mund të vizitojnë faqen e internetit: busulla.com.

Hapi 3

Për të kuptuar më mirë çështjen që trajtohet në këtë mësim, zhvillohet në klasë (së bashku me mësuesin/en) projekti si më poshtë (në librin e nxënësve). Përgjigjet e pyetjeve që kanë në libër, nxënësit i shënojnë në fletë A4 dhe i paraqesin në një kënd të klasës. Përmes turit të galerisë jepen sqarime rreth projektit.

Hapi 4

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur në fletoren e punës, f. 39, 40. Punimet e nxënësve diskutohen në grup fillimisht dhe më pas në mënyrë frontale.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Buletini i pjesëmarrjes.

Punimi i projektit.

Detyrë shtëpie

Me ndihmën e prindërve, pyetjet e mësipërme së bashku me përgjigjet mund t'i hidhni në *PowerPoint*. Më pas, projektin paraqiteni në klasë (në *PowerPoint*), duke ilustruar me fotografi profesionet që ju pëlqejnë më shumë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Karriera		Rezultati i të nxënit të temës: Tregon hobin dhe imagjiron përshtatjen e tij me profesionin e preferuar.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; III.1,3; V.2.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 7.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 5.2 Profesionin e ëndrrave			
Fjalët kyçe: profesion, hobi, lëndë mësimore.			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: 1. Tregon hobin/profesionin e tij të ardhshëm duke dhënë arsye. 2. Veçon aftësitë e tij në lëndët mësimore për të përcaktuar profesionin. 3. U përgjigjet pyetjeve të shtruara duke dhënë argumente.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: mete të ndryshme të konkretizimit për lojën “Emërtimi i profesioneve”, teksti, fletë A4.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe. Shoqëria dhe mjedisi, Art figurativ.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Ftohen nxënësit të imitojnë një profesion të caktuar. Ai që e gjen profesionin, ftohet të imitojë një tjetër. Loja përsëritet disa herë. Arditit i pëlqejnë shumë kafshët. Sa herë që ka kohë, ai shikon dokumentarë, ose lexon enciklopedi për kafshët dhe habitatet e tyre. • Si mendoni, në ç’profesion e shihni në të ardhmen Arditin? Pse? • Po ju, me çfarë merreni në kohën e lirë? • Çfarë dëshironi të bëheni në të ardhmen? • Cili është profesioni i ëndrrave tuaja? • Argumentoni përgjigjet, duke vënë në pah aftësitë tuaja. (Diskutim rreth hobit të nxënësve.)			
Hapi 2 Njihen nxënësit me temën dhe në bashkëpunim me ta, caktohen kriteret e suksesit për njësinë mësimore. Lexohet teksti dhe analizohet përmes pyetjeve. • Me çfarë duhet të jetë i lidhur profesioni që zgjedhim? Pse?			

- Si mendoni, sa i rëndësishëm është vendimi për zgjedhjen e profesionit? Pse mendoni ashtu?
- Si lidhen lëndët mësimore me profesionet?

Lëndët mësimore	Disa nga profesionet që lidhen me to
Gjuhët dhe komunikimi (Gjuhë amtare dhe gjuhë e huaj)	Redaktor letrar, gazetar, shkrimtar, aktor, përkthyes, mësues.
Artet (Edukatë figurative dhe Edukatë muzikore)	Dizenjator, piktor, skulptor, grimier, fotograf, arkitekt, muzikant, mësues.
Matematikë	Matematikën, ekonomist, inxhinier, mësues.
Shkencat natyrore (Njeriu dhe natyra)	Mjek, fermer, agronom, elektrikist, radiograf, fizioterapist, luleshitës, veteriner, infermier, laborant dentar, fizikan, kimist, biolog, mësues.
Shoqëria dhe mjedisi	Gjeograf, topograf, arkitekt, gjeolog, ekologjist, pilot, marinar, arkeolog.
Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	Sportist, trajner, ushtarak, zjarrfikës, trupprojë.

Shëno ku e shikon veten.

- Pse pikërisht aty? Sqaro.

Diskutohet se, për të zgjedhur një profesion, nuk mjafton vetëm prirja ose talenti, por duhet edhe pasioni (hobi) për të.

- Cilat janë këshillat për zgjedhjen e profesionit? (Diskutim)

Hapi 3

Në vazhdim, nxënësit diskutojnë rreth rubrikës “Provo veten”.

- Përshkruaj shkurtimisht çfarë nevojitet për të zgjedhur një profesion të caktuar.
- Pse është i rëndësishëm vetëbesimi?

Në pjesën e fundit të orës, nxënësit u përgjigjen pyetjeve në fletë A4 dhe më pas, i diskutojnë në grup.

- Cila nga lëndët mësimore të pëlqen më shumë?
- Cili është hobi ose pasioni yt?
- A mendon se një ditë, hobi do të kthehet në profesionin tënd? Argumento përgjigjen.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Buletini i pjesëmarrjes.

Përgjigjet gjatë analizës së tekstit.

Detyrë shtëpie

Fletore pune, f. 41, 42.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathhtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Karriera		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon llojet e profesioneve të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1; III.2,7; V.8.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 5.3 Llojet e profesioneve dhe veçoritë e tyre			
Fjalët kyçe: profesione, shkathhtësi, cilësi personale, kualifikime.			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: - Hulumton në internet për llojet e ndryshme të profesioneve. - Veçon informacionet përmes shenjave përkatëse. - Analizon gjetjet në bashkëpunim. - Dallon lloje të ndryshme profesionesh. - Plotëson saktë tabelën në mënyrë të pavarur.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: burime nga interneti, teksti, organizuesi grafik, mjete TIK-u.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Për pesë minuta, nxënësit hulumtojnë në internet për llojet e ndryshme të profesioneve (nëse është e mundur). Aktivitet: Bazuar në njohuritë që morët në mësimin e mëparshëm dhe në hulumtimin në internet, bëni një listë me llojet e profesioneve. Veçoni dy ose tri karakteristika që i dallojnë profesionet nga njëri-tjetri. Diskutoni në klasë bashkë me mësuesin/en.			
Hapi 2 Nxënësit njihen me temën dhe në bashkëpunim me mësuesin/en caktohen kriteret e suksesit për njësinë mësimore. Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin dhe gjatë leximit, ata duhet të vendosin shenjat e mëposhtme në tekst: - Vendosni shenjën “√” (tik), nëse diçka që lexoni, pohon atë që dini ose mendoni se dini. - Vendosni një “+” (plus), nëse një pjesë e informacionit që ndeshni, është i ri për ju. - Vendosni një “-” (minus), nëse një ose disa prej informacioneve që lexoni, kundërshton ose është i ndryshëm nga ajo çfarë dini ose mendoni se dini.			

- Vendosni një “ ? ” (pikëpyetje), nëse ka informacion që është i paqartë për ju ose nëse duhet të dini më shumë rreth këtij informacioni.

Informacioni i shenjzuar hidhet më pas në tabelën INSERT, sipas shenjave përkatëse.

“ √ ”	“ + ”	“ – ”	“ ? ”

Analizohen të dhënat që kanë paraqitur nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga ana e mësuesit/es apo nxënësve.

Hapi 3

Në pjesën e fundit të orës, nxënësit plotësojnë në mënyrë individuale tabelën e mëposhtme.

Profesioni	Lënda/profili i punës	Kualifikimi
Mësimdhënës		
Fermer		
Redaktor		
Fotograf		

Përmes teknikës “Stilolapsi në mes”, lexohen punimet e nxënësve dhe diskutohen.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Buletini i pjesëmarrjes gjatë analizës së tekstit.

Të menduarit në mënyrë kritike në përgjigjet e dhëna.

Detyrë shtëpie

Fletore pune, f. 43, 44

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Karriera		Rezultati i të nxënit të temës: Harton një miniplan për shkathtësitë/aftësitë e tij/saj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; III.2,7.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 7.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 5.4 Planifikimi i karrierës			
Fjalët kyçe: plan, karrierë, profesion, aftësi, shkathtësi			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: • Plotëson figurën me njohuritë paraprake për hartimin e miniplanit. • Krijon miniplanin duke u bazuar në udhëzime. • Sqaron miniplanin që ka krijuar në mënyrë individuale.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, organizuesi grafik, fletore pune, burime nga interneti			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Aktivitet: A keni hartuar ndonjëherë një plan të thjeshtë (miniplan)? Cili ka qenë qëllimi? A është realizuar ashtu siç e kishit parashikuar? Përpikuni të kujtoni hapat e tij, duke plotësuar figurën në krah. Lexohen disa nga punimet e nxënësve dhe diskutohen.			
Hapi 2 Njihen nxënësit me temën dhe në bashkëpunim me mësuesin/en caktohen kriteret e suksesit për njësinë mësimore. Pasi të jetë lexuar paragrafi i parë dhe të jetë sqaruar nga mësuesi/ja në bashkëveprim me nxënësit rëndësia e krijimit të një plani, vijohet me hapat e krijimit të miniplanit.			

- Fillimisht, udhëzohen nxënësit që të bëjnë një listë të profesioneve që mendojnë se përshtaten me shkathësitë, prirjet dhe hobet tyre dhe pranë secilit profesion, të shënojnë kriteret ose kërkesat që ka secili profesion (nxënësit bazohen në të dhënat në libër). Në këtë mënyrë, vazhdohet për pesë hapat; hapi i gjashtë dhe i shtatë diskutohen.

Hapi 3

Në vazhdim, u kërkohet nxënësve të plotësojnë kërkesën e rubrikës “Provo veten”.

Krijoni miniplanin tuaj duke iu përgjigjur vetëm 5 pikave të para të shpjeguara në këtë mësim.

Diskutim i përbashkët.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Buletini i pjesëmarrjes.

Vlerësohen për krijimin e miniplanit duke iu përgjigjur 5 pikave të para.

Detyrë shtëpie

Plotëso mozaikun në fletore pune fq. 45

Për t’u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, mund të hulumtoni në faqen e internetit *Busulla.com*.

<https://mileniumi3.net/orientimi-ne-karriere/>

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Karriera		Rezultati i të nxënit të temës: Liston ide të ndryshme lidhur me karrierën	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; III.2,7; IV.2; V.8.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 7.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 5.5 Procesi i orientimit të karrierës			
Fjalët kyçe: karrierë, orientim, informacion, prezantim, komunikim			
Rezultati/et i të nxënit për orë mësimore: - Diskuton me të ftuarin në klasë për profesionin e tij. - Analizon tekstin me shokun në krah dhe jep sqarime. - Liston pyetjet e duhura për të intervistuar një artist mbi karrierën.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: burime njerëzore (prind me një profesion të caktuar), teksti.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Shkathësi për jetë, Art figurativ, Edukim për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Ftohet në klasë një person nga komuniteti i prindërve të klasës që ka një profesion të caktuar (mësuesi/ja e fton paraprakisht). I ftuari u jep sqarime nxënësve për profesionin e tij, rrugëtimin për të arritur profesionin e dëshiruar, përvojat etj. Nxënësit i shtrojnë pyetje për gjërat që u interesojnë. (Në pamundësi për të ftuar në klasë dikë, ora mund të fillojë me aktivitetin në librin e nxënësit.) Aktivitet: Zhvilloni një intervistë të shkurtër me shokun ose shoqen e bankës. Niseni me pyetjen: A ke menduar ndonjëherë për profesionin që do të bësh në të ardhmen?			
Hapi 2 Njihen nxënësit me temën dhe në bashkëpunim me mësuesin/en caktohen kriteret e suksesit për njësinë mësimore. Teksti ndahet në paragrafë dhe nxënësit, në çift, analizojnë pjesën e caktuar. Pasi lexojnë paragrafin dhe e diskutojnë në çift, përfundimet e nxjerra i paraqesin para klase. Çifti duhet të japë sqarime, t'u përgjigjet pyetjeve të shtruar nga shokët/shoqet në klasë dhe në fund, t'u shtojë pyetje nxënësve rreth paragrafit të trajtuar.			

Për secilën pjesë të lexuar veprohet në të njëjtën mënyrë. Mësuesi/ja jep sqarime shitesë nëse mbetet diçka pa u thënë. Orientohen nxënësit të listojnë në fletoret e tyre idetë e ndryshme lidhur me karrierën. Disa punime të nxënësve lexohen.

Hapi 3

Nëse do të bëjmë një vizitë në teatër dhe do të bashkëbisedoni me një profesionist, për shembull, me një aktor teatri, cilat pyetje do t'i shtroni?

Ja, disa nga pyetjet që mund t'i drejtoni:

- Kur ju ka lindur dëshira për t'u bërë aktor?
- A keni pasur talent në recitim ose interpretim kur ishit fëmijë?

U kërkohet nxënësve të përgatisin pyetjet për intervistimin e një aktori në teatër. Pyetjet e përgatitura nga nxënësit lexohen para klase dhe diskutohen për nivelin e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për diskutimin në klasë.

Analiza e tekstit.

Lloji i pyetjeve të përgatitura për bashkëbisedim.

Detyrë shtëpie

Reflektim rreth vizitës në teatër.

(Aktivitet jashtëkurrikular)

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Kapitulli 6

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathtësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Media		Rezultati i të nxënit të temës: Organizon aktivitete shkollore sipas ideve të grupit, incizimi, prezantimi e postimi në faqet e shkollës dhe mediet lokale.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 8; II. 5; III. 2; IV. 3, 4			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2. 1; 4. 2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 6.1 Roli i medias në jetën shkollore			
Fjalët kyçe: media, aktivitete, program kompjuterik			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: - kontribuon në grup sipas udhëzimeve të aktivitetit; - analizon informacionet për përdorimin e programit <i>Canva</i>; - vlerëson përdorimin e programit <i>Canva</i> për prezantimin e projektit; - organizon aktivitetin në bashkëpunim me grupin.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesja/si në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Aparat fotografik ose telefon celular, fleta <i>flip-charter</i> , ngjitës, shënjes ose lapsa me ngjyra, videoprojektor, kompjuter, burime nga interneti https://www.canva.com/posters/ .			
Lidhja me lëndet tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Art figurativ, Edukimi për media.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Aktivitet: “Kontribuoj për mediat” Hapet diskutimi me pyetjen: Çfarë dini për mediat? Ndahen nxënësit në tri grupe, secili grup duhet të kontribuoj sipas kërkesës në afshen që i jep mësuesi/ja.			

Grupi i parë: shkruan një lajm për gazetën ditore (media e shkruar).

Grupi i dytë: komunikon një lajmë në TV (media vizive).

Grupi tretë: emiton një reklamë në radio (media e dëgjuar).

(Prezantim i punës së grupit)

- A keni zhvilluar ndonjë konkurs a veprimtari jashtëshkollore?
- Çfarë ju ka mbetur në mendje prej saj?
- Përshkruani ndjesitë dhe diskutoni rreth tyre me shokët/shoqet e klasës.

Hapi 2

Njoftohen nxënësit me temën dhe në bashkëpunim me mësuesin/en caktohen kriteret e suksesit për njësinë mësimore. Fillimisht diskutohet se si pjesëmarrja në lojëra elektronike, qëndrimi i gjatë para kompjuterit ose televizorit po i largon gjithnjë e më shumë ata nga komunikimi fizik. Jepen sqarime se sa është e rëndësishme që nxënësit të marrin pjesë aktive në aktivitetet që organizon shkolla, të cilat nxitin tek ata krijimin e ndjenjës së përkatësisë dhe nevojës për të bashkëpunuar me tjetrin.

Hapi 3

Njoftohen nxënësit për aktivitetin jashtëklase që do të realizojnë në bashkëpunim me mësuesin/en. Ndahen nxënësit në grup dhe njoftohen me mjetet e punës. Udhëzohen nxënësit të veprojnë sipas udhëzimeve në librin e nxënësve për realizimin e aktivitetit (projektit). Për prezantimin e aktivitetit *online* jepen udhëzime për përdorimin e programit *Canva*. Udhëzimet që jep mësuesi/ja (që janë në libër) njëkohësisht i demonstroi para nxënësve që të shohin se si përdoret programi *Canva*. Nëse është e mundur, mësimi të mbahet në kabinetin e TIK-ut, që nxënësit ta praktikojnë njëkohësisht.

(Nëse nuk ka mundësi të realizohet një poster në *Canva*, veproni sipas hapave të përshkruar në fillim të këtij mësimi. Nxënësit prezantojnë punimin e tyre në klasë dhe diskutojnë me shokët/shoqet rreth tij.)

Hapi 4

Diskutim i hapur:

- A ju duket i thjeshtë prezantimi në programin *Canva*? Pse?

(Njoftohen nxënësit që posterin mund t'ua prezantojnë prindërve dhe nxënësve të tjerë të shkollës. Gjithash-tu, mund t'ua dërgojnë mediave lokale, në mënyrë që projekti i tyre për të ardhmen e zonës ku banojnë, të përcillet edhe te komuniteti.)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Buletini i pjesëmarrjes.

Detyrë shtëpie

Fletore pune, f. 47, 48.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Media		Rezultati i të nxënit të temës: Organizon aktivitete dhe gara të ndryshme që paraqesin veprime ndërmarrëse (p.sh., gara për fotografi, vizatime, krijime të ndryshme etj.).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3; II. 5; III. 4; IV. 4			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2. 1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 6.2 Zhvillimi i aftësive ndërmarrëse			
Fjalët kyçe: ndërmarrësi, garë.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore			
Nxënësi/ja: - përgjigjet në pyetjet e shtruara duke bashkëpunuar me shokun në krah; - organizon punon në grup për të garuar; - kontribuon në grup sipas aftësive që posedon; - sqaron përvojën e tij/saj gjatë aktivitetit/garës.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesja/si në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti, telajo, ngjyra uji, penela, fleta A4, flip-charter, ngjitës, shënjes ose lapsa me ngjyra, mjete të ndryshme ricikluese (mjete të ndryshme, varësish prej aktivitetit që realizohet në klasë).			
Lidhja me lëndet tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Art figurativ, Edukimi për media.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Udhëzohen nxënësit që në bashkëpunim të shkruajnë rreth pyetjeve të shtruara: Mendo/Puno në dyshe/thuaja të tjerëve - Çfarë kuptoni me termin “ndërmarrësi”? - Si mendoni, me se ka lidhje ky term? - Në cilën fushë e keni dëgjuar më shpesh?			

Hapi 2

Njoftohen nxënësit me temën dhe në bashkëpunim me nxënësit caktohen kriteret e suksesit për njësinë mësimore. Lexohet teksti nga ana e nxënësve, i ndarë në paragrafë. Nxënësi që lexon paragrafin jep sqarime rreth pjesës së lexuar, u përgjigjet pyetjeve të shtruara nga nxënësit tjerë si dhe bën pyetje rreth sqarimeve që ka dhënë. Në këtë mënyrë veprohet edhe me paragrafët e tjerë, me nxënës të ndryshëm. Pasi të jetë analizuar përmbajtja mësuesi/ja ndan nxënësit në 5 ose 6 grupe me nga 4 anëtarë (varësisht nga numri i nxënësve në klasë). Secili grup, në bazë të aftësive ose prirjeve që kanë nxënësit, do të kryejë një detyrë të caktuar.

1. Grupi i pikturës
2. Grupi i krijimit të objekteve me materiale të riciklueshme
3. Grupi i prodhimeve artizanale
4. Grupi i organizimit të panairit ushqimor
5. Juria (4 nxënës)

Mësuesi/ja sqaron qëllimin dhe rezultatet e pritshme të aktivitetit. Gjatë orës organizohet gara brenda klase (improvizohet shit/blerja e produkteve) ku nxënësit në rolin e jurisë zgjedhin grupin fitues. (Mund të organizohet gara me më pak grupe/aktivitete, mësuesi/ja përzgjedh cili aktivitet është më i përshtatshëm për t'u realizuar në klasën e tij/saj.)

Hapi 3

Diskutim i hapur rreth pyetjeve të rubrikës “Provo Vetën”.

- Çfarë mësove gjatë aktivitetit që zhvillove së bashku me shokët/shoqet?
- Si mendon, a do të të shërbejnë në të ardhmen aftësitë që fitove?
- Çfarë roli kishte në grupin ku more pjesë?
 - o A e realizove këtë rol me sukses? Argumento përgjigjen.
- Cilat nga aftësitë e fituara mendon se do të të shërbejë në të ardhmen?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për organizimin e aktivitetit në klasë.

Vlerësohen për punën praktike.

Detyrë shtëpie

Fletore pune, f. 49, 50.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Media		Rezultati i të nxënit të temës: Përdor lojëra të ndryshme kompjuterike me sens ndërmarrës	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3; III. 2, 4			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4. 1; 5. 1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 6.3 Lojëra kompjuterike për të nxitur aftësitë ndërmarrëse			
Fjalët kyçe: lojëra kompjuterike, sisteme ekonomike, ndërmarrësi, të ardhura.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: • arsyeton lojërat e parapëlqyera në kompjuter; • dallon rëndësinë e lojërave kompjuterike me sens ndërmarrësie; • jep sqarime të sakta për informacionin e ri. Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesja/si në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti https://www.stardewvalley.net/ , kompjuter, projektor, teksti, organizuesi grafik.			
Lidhja me lëndet tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Njeriu dhe natyra, Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë; Edukimi për media.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Luhet loja “Gjej fjalën që kam në mendje”. Ndahen nxënësit në dy grupe dhe u jepen udhëzimet e lojës. • Mendo një fjalë dhe përgjigju pyetjeve të shtruar me Po/Jo. • Grupi që zbulon më shumë fjalë fiton lojën. Orientohen nxënësit të mendojnë fjalë rreth mësimit të orës së kaluar (ndërmarrësi, garë, media...etj.).			

Hapi 2

- Cilat janë lojërat që ju pëlqejnë më shumë dhe keni dëshirë t'i luani me shokët dhe shoqet në lagje?
- Po nga lojërat kompjuterike, cilën do të veçoni?
- Pse ju pëlqen kjo lojë? (Diskutim)

Hapi 3

Njoftohen nxënësit me temën që do të trajtohet dhe në bashkëpunim caktojnë kriteret e suksesit.

Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin në dyshe.

Roli i parë është roli i raportuesit, i cili lexon pjesën me kujdes dhe përgatitet të përmbledh përmbajtjen e asaj pjese. Pasi ta lexojnë pjesën e vet, ata i tregojnë partnerit të tyre për përmbajtjen e pjesës.

Roli i dytë është ai i përgjigjedhënesit. Edhe përgjigjedhënesit lexojnë pjesën dhe dëgjojnë me kujdes raportuesin. Kur të mbarojë raportuesi, përgjigjedhënesi i bën pyetje raportuesit, për të sqaruar leximin. Në vazhdim, dyshet sjellin përfundimet e nxjerra para klase.

Teksti ndahet në tri pjesë:

- video-lojëra, paragrafi i parë.
- video-lojërat, paragrafi i dytë.
- Mësimi nëpërmjet lojës *Stardew Valley*. (Mësuesi/ja ndërkohë prezanton para nxënësve adresën <https://www.stardewvalley.net/>, ku mund të marrin të gjitha informacionet dhe e demonstرون para nxënësve duke u bazuar në të dhënat në libër.)

Hapi 4

Udhëzohen nxënësit që në grup të plotësojnë organizuesin grafik me informacionet kyçe për dy pjesët e trajtuara.

Video-lojërat	Mësimi nëpërmjet lojës

Diskutim i hapur rreth punimeve të nxënësve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësohen për sqarimin e përmbajtjes. Vlerësohen për përmbledhjen e drejtë të informacioneve në tabela.
Detyrë shtëpie
Përshkruaj shkurtimisht aftësitë që të zhvillon loja <i>Stardew Valley</i>. • Si e kupton shprehjen: “Mëso ta duash tokën”? Argumento.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Mediat		Rezultati i të nxënit të temës: Plotëson tabelat ku përcaktohen nevojat dhe shpenzimet në familje, duke përdorur programe kompjuterike	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3; II. 4; III. 2, 4, 9			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 6.4 Shpenzimet në familje			
Fjalët kyçe: shpenzime, buxhet, nevoja familjare.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - analizon tekstin me ndalesa; - plotëson tabelën dhe krahason shpenzimet me nevojat dhe dëshirat; - argumenton rëndësinë e të kursyerit në shpenzimet familjare. Kriteret e suksesit: i plotëson mësuesja/si në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, kalkulatori, fletë A4, fletë A3.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë amtare, Matematikë.			
Zhvillim personal dhe shkathësi për jetë; Edukim për media.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Aktivitet: Në një fletë A4 shkruani një listë me blerjet që keni bërë kohët e fundit. Pjesë e kësaj liste mund të jenë mjete shkollore, libra, veshje, fruta, ëmbëlsira etj. Diskutoni rreth shpenzimeve që ka bërë secili prej jush. (Diskutim i hapur para klase).			
Hapi 2 Nxënësit njihen me temën dhe në bashkëpunim me ta, caktohen kriteret e suksesit për njësinë mësimore. Lexohet nga ana e nxënësve teksti i ndarë në paragrafë. Nxënësi që lexon paragrafin, jep sqarime rreth pjesës së lexuar, u përgjigjet pyetjeve të shtruara nga nxënësit e tjerë, si dhe bën pyetje rreth sqarimeve që ka dhënë. Në këtë mënyrë, veprohet edhe me paragrafët e tjerë, me nxënës të ndryshëm. Pasi të diskutohet paragrafi i parë, nxënësit diskutojnë për nevojat dhe dëshirat në ilustrim.			
Hapi 3 Nxënësit plotësojnë tabelën me emrat e nevojave dhe dëshirave, duke shënuar edhe çmimet përkatëse. (Nëse është e realizueshme, nxënësit mund të plotësojnë tabelën duke përdorur programe kompjuterike).			
Nevojat	Çmimi	Dëshirat	Çmimi
1.		1.	
2.		2.	
3.		3.	
4.		4.	
Komunikimi	Shuma		Shuma

Njëkohësisht bëjnë llogaritjet duke përdorur kalkulatorët. Hapet diskutimi duke bërë krahasimet e shpenzimeve, fillimisht në çift, e pastaj diskutim i hapur në mënyrë frontale, ku theksi vihet te shpenzimet e bëra te dëshirat.

Hapi 4

Pas analizës së tekstit, shtrohet pyetja:

Si mund të kontribuoni ju në kursimet familjare?

Nxënësit në grupe (në fleta A3) shënojnë mendimet e tyre dhe i argumentojnë ato para klase.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Analiza e tekstit.

Buletini i pjesëmarrjes.

Detyrë shtëpie

Rubrika: Provo veten

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: Shkathësi për jetë	Shkalla e kurrikulës: 2	Klasa: V
Tema: Mediat		Rezultati i të nxënit të temës: Fotografon dhe mbledhë shenjat sinjalizuese të rrezikut dhe mbrojtjes në punë si dhe i vendos në tabelat e shkollës.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 2, 3; III. 8; IV. 3, V. 7			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 6.5 Shenjat sinjalizuese			
Fjalët kyçe: profesion, kujdes, sinjalistikë, evakuim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: - tregon për sigurinë e tij/saj në situata të ndryshme; - analizon këshillat për secilën situatë që paraqet rrezik; - shkruan ese informuese për temën e dhënë; - vendos shenjat sinjalizuese në tabelën e shkollës.			
Kriteret e suksesit: I plotëson mësuesja/si në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, ilustrime të shenjave sinjalizuese, fletore pune, Fletë A4, ngjyra.			
Lidhja me lëndet tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, shoqëria dhe mjedisi, Art figurativ, Zhvillimi personal dhe shkathësitë për jetë; Edukimi për media			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Aktivitet: Nxënësit ndahen në tre grupe dhe secili grup e merr për detyrë që të mendojë dhe vizatojë ose shkruajë në një fletë të madhe të letres sesi në mjedisin gjegjës vetë fëmijët kujdesen për sigurinë e tyre, si dhe kush mund t'u ndihmojë atyre nëse gjenden në situata të pasigurta ose të rrezikshme. Grupi I – në shtëpi Grupi II – jashtë Grupi III – në shkollë Pasi të përfundojnë, nga një përfaqësues i secilit grup e prezanton para të tjerëve atë që është shkruar dhe e ngjet fletën e letres në një vend të dukshëm në klasë.			

- Çfarë dini për shenjat sinjalizuese?
- Përse shërbejnë ato? Ku i keni parë?
- Po në shkollë, keni vërejtur shenja sinjalizuese?

Hapi 2

Njoftohen nxënësit me temën që do të trajtohet dhe në bashkëpunim caktojnë kriteret e suksesit. Lexohet teksti me ndalesa dhe në bashkëpunim me nxënësit arrihet në përfundim se:

Rreziqet dhe shenjat sinjalizuese së bashku me këshillat janë si më poshtë:

- Mbrojtja nga zjarri, evakuimi dhe shpëtimi
- Kujdesi nga rrëshqitja.
- Përdorimi i mjeteve dhe makinerive sipas manualeve të përdorimit.
- Rreziku elektrik.
- Ndotja akustike dhe zhurmat.

Hapi 3

Pasi të jenë analizuar këshillat (shih në librin e nxënësve) për secilën pikë më lart, udhëzohen nxënësit të reflektojnë për njohuritë e marra, duke shkruar në mënyrë individuale ese informuese (faktike) për temën. Punimet vendosen në Turin e galerisë. Përmes stilolapsit në mes disa punime të nxënësve lexohen para klase.

Hapi 4

Nxënësit plotësojnë në mënyrë individuale fletoren e punës, f. 51, 52.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Diskutimi i përbashkët.
Analiza e tekstit.
Eseja punuar për temën.

Detyrë shtëpie

Të punohet Aktivitete 2 gjatë javës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

TEST 1

Emri/Mbiemri: _____

Data: _____

1. Shkruaj materialet ndërtimore që di:

5 pikë

.....

.....

.....

.....

2. Si i dallon materialet ndërtimore nga njëri-tjetri?

5 pikë

.....

.....

3. Emërto dhe shkruaj një informacion për materialin përkatës (Shih shembullin).

12 pikë



*Gjipsi - Fjala gjips rrjedh nga greqishtja e
vjetër dhe do të thotë "suva".*



Materialet
ndërtimore



.....

.....

.....

.....

4. Plotëso tabelën për të treguar vetitë dhe përdorimin e tri materialeve ndërtimore:**15 pikë**

Materiale ndërtimore	Vetitë	Përdorimi
Çimentoja		
Stiropori		
Graniti		

5. Vendos fjalët e duhura në vendet boshe**6 pikë***(internetit, në grup, Projektet, plan, produkti, burime).*

Në rastin e një punëdoreje, projektishërben për krijimin dhe realizmin e një _____ të caktuar. Për të kuptuar më mirë atë që kërkohet, ju duhet të kërkonit në _____ të ndryshme informacioni nëpërmjet _____. Është shumë e rëndësishme që informacioni të analizohet në mënyrë kritike dhe të vlerësohen ato burime që ju duhet për projektin. _____ mund të realizohen në mënyrë të pavarur ose _____. Për realizimin e projektit, duhen ndjekur disa hapa të përcaktuar, pra duhet formuluar një _____.

6. Sqaro si do ta bëje ti një plan të projektit.**12 pikë**

Plani i projektit

**7. Lidh me shigjetë fjalitë me fjalën përkatëse.****5 pikë**Softuerë për përpunimin e tekstit dhe prezantimi e tij. ☐☐ Google☐ Microsoft Word☐ BingMjete (motorë) për kërkim në internet. ☐☐ PowerPoint

8. Disa nga mjetet digjitale që mund të përdoren në krijimin dhe prezantimin e projekteve janë:

5 pikë

.....

.....

.....

9. Plotëso tabelën sipas kërkesës:

15 pikë

Emërto figurën.	Trego funksionin.
	
	
	
	

10. Si mendon, përdorimi i TIK-ut është i dëmshëm për fëmijët?
Po (pse?), Jo (pse?). Argumento.

20 pikë

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Tabela e vlerësimit

0-39 (1)	40-59 (2)	60-79 (3)	80-89 (4)	90-100 (5)	Nota

TEST 2

Emri/Mbiemri: _____

Data: _____

1. Në tabelën e mëposhtme, sqaro kuptimin e fjalëve:

12 pikë

<i>Diversiteti</i>	
<i>Diskriminim</i>	
<i>Ekologji</i>	
<i>Habitat</i>	

2. Zanës i pëlqen shumë futbolli. Në orën e Edukatës fizike, ajo dëshironte të luante futboll me shokët. Të gjithë shokët e klasës e kundërshtuan dhe nuk e lejuan të luante. “Ik, se ti je vajzë”, – i thanë. Shkruaj cili është qëndrimi juaj për këtë situatë.

10 pikë

.....

.....

3. Lidh me shigjetë gjallesën me habitatin e saj.

5 pikë



4. Vendosi fjalët e duhura në vendet boshe
(veprimtarive, klime, njeriut, prerja, ngrohja globale).

6 pikë

Me ndryshim _____ kuptojmë ndryshimin e kushteve të zakonshme të motit përgjatë viteve në planetin tonë. Vlerat e temperaturës së ajrit janë rritur shumë, për shkak të _____ të ndryshme të _____ në mjedis, si: djegia e sasive të mëdha të lëndëve djegëse fosile, _____ e pemëve dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve për mbjelljen e drithërave dhe kullotave për kafshët. Të gjitha këto kanë çuar në atë që njihet si _____.

5. Plotëso tabelën sipas kërkesës:

7 pikë

Cilët janë faktorët që ndotin mjedisin ku ju jetoni?	Si kontribuoni ju?

6. Shkruaj si i kupton fjalët:

12 pikë

Ekonomi familjare, nevojë parësore, nevojë dytësore, menaxher i shtëpisë.

.....

.....


.....

.....

.....

7. Shkruaj në diagram të veçantat dhe të përbashkëtat e *Mallrave* dhe *Shërbimeve*.

12 pikë



8. Shkruaj një shembull kur ti je prodhues dhe kur ti je konsumator.

10 pikë

.....

.....

.....

.....

.....

.....

9. Menaxheri i mirë duhet të ketë këto aftësi:

6 pikë



- | | |
|---------------------------------|---------|
| 1. <i>Organizimi</i> | 4. |
| 2. | 5. |
| 3. | 6. |

10. Si do të veprosh ti në të ardhmen, që të jesh menaxher i mirë?
Cili është plani juaj?

20 pikë

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Tabela e vlerësimit

0-39 (1)	40-59 (2)	60-79 (3)	80-89 (4)	90-100 (5)	Nota

TEST 3

Emri/Mbiemri: _____

Data: _____

1. Sqaro fjalët:

12 pikë

Karrierë	
Profesion	
Orientim	

2. Lidh me shigjetë fushat (lëndët) me profesionet që lidhën me të.

6 pikë

- | | | | |
|--------------------------------------|-----------------------|-----------------------|---|
| Gjuhët dhe komunikimi | ☐ | ☐ | Matematikan, ekonomist, inxhinier, mësues. |
| Artet | ☐ | ☐ | Sportist, trajner, ushtarak, zjarrfikës, trupprojë. |
| Matematikë | ☐ | ☐ | Mjek, fermer, agronom, elektrikist, radiograf, Fizioterapist, luleshitës, veteriner, infermier, laborant dentar, fizikan, kimist, biolog, mësues. |
| Shkencat natyrore | ☐ | ☐ | Disenjator, piktor, skulptor, grimier, fotograf, arkitekt, muzikant, mësues. |
| Shoqëria dhe mjedisi | ☐ | ☐ | Redaktor, gazetar, shkrimtar, aktor, përkthyes, mësues. |
| Edukata fizike, sportet dhe shëndeti | ☐ | ☐ | Gjeograf, topograf, arkitekt, gjeolog, ekolog-jist, pilot hapësire, marinar, arkeolog. |

3. Pranë çdo pohimi vendos Po ose Jo.

8 pikë

Puna në natyrë – Të punosh në natyrë, do të thotë të përdorësh ose të shfrytëzosh burimet e Tokës.

Punë të tillë bëjnë: fermeri, veterineri, bletërritësi etj. _____

Puna me pajisje – Kjo punë bazohet në teknologji, kryesisht në mirëmbajtjen dhe funksionimin e një pajisjeje. Profesionistë të këtij profili janë: mësuesit, dadot, përkthyesit etj. _____

Puna me një person – Krahas kualifikimit ose përvojës së duhur, ky profil pune kërkon aftësi shumë të mira komunikuese, korrektësi dhe respektim të rregullave të etikës. Në këtë grup profesioneve përfshihen: operatorët e makinerive, specialistët e riparimit, fotografët etj. _____

4. Vendos sipas radhës (1, 2, 3, 4, 5, 6, 7) hapat për hartimin e një miniplan për planifikimin e karrierës.

8 pikë

_____. Analizoni rezultatet.

_____. Vlerësoni sa përputhen aftësitë/shkathtësitë tuaja me natyrën e secilit profesion të zgjedhur.

_____. Përcaktoni rëndësinë e secilit prej kriterëve të mësipërme.

_____. Bëni një listë të profesioneve që mendoni se përshkruhen me shkathhtësitë, prirjet dhe hobet tuaja.

_____. Pranë secilit profesion, shënoni kriteret ose kërkesat që ka secili profesion.

_____. Diskutoni rreth vendimit që morët.

_____. Identifikoni hapat që do të hidhni drejt profesionit që zgjedhët.

5. Si e sheh karrierën tënde në të ardhmen? Pse?

8 pikë

.....

.....

.....

6. Çfarë kupton me fjalët: *ndërmarrësi, media, shenja sinjalizuese*?

10 pikë

.....

.....

.....

.....

.....

.....

7. Shkruaj çfarë di për programin si më poshtë.

8 pikë



8. Cilat lojëra kompjuterike nxisin aftësitë ndërmarrëse? Sqaro, pse?

10 pikë

.....

.....

.....

.....

9. A mendoni se planifikimi i ekonomisë familjare është shumë e rëndësishme në jetën e njeriut? Po/pse? Jo/pse (argumento)

15 pikë

.....

.....

.....

.....

.....

10. Arsyeto nevojën e vendosjes së shenjave të rrezikut në vendin e punës.

15 pikë

.....

.....

.....

.....

.....

Tabela e vlerësimit

0-39 (1)	40-59 (2)	60-79 (3)	80-89 (4)	90-100 (5)	Nota

REFERENCA

- Korniza kurrikulare e Kosovës.
- Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës.
- Kurrikula lëndore/programi mësimor Shkathtësi për jetë, 2019
- Vlerësimi formativ (MASHT/ USAID)
- Udhëzues të ndryshëm për mësimdhënës të klasave fillore.
- Standardet për tekstet shkollore, MASHT, Kosovë.

BURIME NGA INTERNETI:

- <https://www.google.al/>
- <https://www.dreamstime.com>
- <https://www.pinterest.com>

Katalogimi në Botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare E Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.016:37(072)(075.2)

Pruthi, Laura

Shkathtësi për jetë 5 : libër për mësuesin/en : për klasën
e pestë të arsimit fillor / Laura Pruthi. - Prishtinë : Pegi,
2023. - 113 f. : ilustr. ; 28 cm.

ISBN 978-9951-843-06-5